UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" NË MTROVICË

FAKULTETI EKONOMIK

DEPARTAMENTI: MENAXHMENT DHE INFORMATIKË

PUNIM DIPLOME

Mentori: **Kandidati:**

Prof. Asoc. Dr. Qazim TMAVA **Petrit SYLEJMANI**

Mitrovicë
Qershor, 2023

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" NË MTROVICË

FAKULTETI EKONOMIK

DEPARTAMENTI: MENAXHMENT DHE INFORMATIKË

PUNIM DIPLOME

Mentori: **Kandidati:**

Prof. Asoc. Dr. Qazim TMAVA **Petrit SYLEJMANI**

Mitrovicë
Qershor, 2023

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" NË MTROVICË

FAKULTETI EKONOMIK

DEPARTAMENTI: MENAXHMENT DHE INFORMATIKË

Vështrim analitik i buxhetit të Kosovës
Analizë Rasti periudha 2016/2019

Mentori: **Kandidati:**

Prof. Asoc. Dr. Qazim TMAVA **Petrit SYLEJMANI**

Mitrovicë
Qershor, 2023

UNIVERSITY "ISA BOLETINI" IN MITROVICA

FACULTY OF ECONOMICS

DEPARTMENT: MANAGMENT AND INFORMATICS

Analytical overview of the budget of Kosovo
Case analysis period 2016/2019

Supervisor:
Asoc. Prof. Dr. Qazim TMAVA

Candidate:
Petrit SYLEJMANI

Mitrovica,
June, 2023

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" NË MTROVICË

FAKULTETI EKONOMIK

DEPARTAMENTI: MENAXHMENT DHE INFORMATIKË

PUNIM DIPLOME

Lënda: Financa
Titulli i Punimit: Buxheti i Kosovës 2016/2019
Emri dhe Mbiemri: Petrit SYLEJMANI
Statusi i Studentit: i rregullt
Nunmri i Amzës(ID Regjistri):1505021006
Niveli i Studimeve: Bachelor
Departamenti: Menaxhment dhe Informatik
Programi i studimit: Menaxhment dhe Informatik
Mentori i punimit: Prof. Asoc. Dr. Qazim Tmava
Aprovuar prej komisionit:

1. Mentori
   Emri/Mbiemri/Titulli: Prof. Asoc. Dr. Qazim Tmava
2. Anëtar
   Emri/Mbiemri/Titulli
3. Anëtar
   Emri/Mbiemri/Titulli

Deklarat e Origjinalitetit/ Autorësisë

Ky Punim Diplome i nivelit Bachelor është puna ime origjinale duke respektuar autorësinë e çdo niveli të informacioneve dhe rregullave për një punim të mirëfilltë shkencorë, dhe nuk është dorëzuar, në tërësi apo pjesërisht, por ndonjë grade në këtë apo ndonjë universitet tjetër. Sipas njohurisë time, punimi nuk përmban asnjë material të botuar ose shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç siç deklarohet në brendi të tekstit. Gjithashtu, deklaroj se, në shkrimin e punimit kam respektuar rregullat etike të punës shkencore dhe akademike të UMIB.

Statement of Originality/ Authority

This Diploma Thesis, bachelor level, is my origjinal work, respecting dhe authorship of any source of information and rules for a proper scientific work, adn has not been submitted in whole or in part to any degree at this or any other university. According to my know a ledge, the paper does not contain any material published or written by any other person exept as stated in the text. Also, I decelare that writing the thesis I have respected the ethical rules of the scientific and academic work of UMIB.

Data/Date: 2023 Petrit SYLEJMANI

(nënshkrimi-signature)

Abstrakti

Buxheti i Republikës së Kosovës paraqet shumën e lejuar me ligj e cila u vihet në dispozicion për shpenzim nga Fondi i Kosovës për një program apo qëllim specific apo, aty ku nuk është identifikuar qëllimi specifik, për një kategori të shpenzimeve të një organizate Buxhetore, si është e paraparë me Ligjin Vjetor për Buxhetin.
Ligji bazik për Buxheti e Republikës së Kosovës është Ligji mbi Menaxhimine Financave Publike dhe Përgjegjësive Nr. 03/L-048 i vitit 208, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221 në korrik të vitit 2010. Ndërsa, për çdo vit nxirret Ligji Vjetor I Buxhetit, që përcakton Buxhetin vjetor të Rrpublikës së Kosovës.

Në Republikën e Kosovës ekzistojne dy nivele të buxhetit: Niveli Qendror dhe Niveli lokal (komunat).

Ligji Vjetor i Buxhetit përveç dispozitave ligjore të përcaktuar përmban edhe tabelat, të cilat paraqesin të dhënat për vitin paraprak, vitin aktual dhe tre vitet e ardhme (ku viti i parë paraqet vitin buxhetor, ndërsa dy vitet tjera janë vlerësime).

Për t'u kuptuar, me termin Organizatë Buxhetore nënkuptojmë të gjitha Ministritë, Komunat apo Agjencitë të cilat pranojnë ndarje buxhetore nga Fondi i Konsoliduar sipas Ligjit Vjetor të Buxhetit. Buxheti i paraparë për Ministritë, Agjencionet e Pavarura (të cilat janë të themeluara sipas Kushtetutesë apo me ligj) dhe për komunat, i konsoliduar, paraqet Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Fjalë kyçe: Buxhet, Organizatë Buxhetore, Ministritë, Agjensionet e Pavarura, Kosovë.

Abstract (anglisht)

The Budget of the Republic of Kosovo represents the amount allowed by law which is made available for spending by the Kosovo Fund for a specific program or purpose or, where no specific purpose has been identified, for a category of expenses of a Budgetary organization, such as is foreseen by the Annual Law on the Budget.
The basic law for the Budget of the Republic of Kosovo is the Law on Public Finance Management and Responsibilities No. 03/L-048 of the year 208, amended and supplemented by Law No. 03/L-221 in July 2010. Meanwhile, the Annual Budget Law is issued every year, which determines the annual Budget of the Republic of Kosovo.

In the Republic of Kosovo, there are two budget levels: Central Level and Local Level (municipalities).

The Annual Budget Law, in addition to the defined legal provisions, also contains the tables, which present the data for the previous year, the current year and the three future years (where the first year represents the budget year, while the other two years are estimates).

To be understood, by the term Budgetary Organization we mean all Ministries, Municipalities or Agencies that accept budget allocations from the Consolidated Fund according to the Annual Budget Law. The budget foreseen for the Ministries, Independent Agencies (which are established according to the Constitution or by law) and for the municipalities, consolidated, represents the Budget of the Republic of Kosovo.

Keywords: Budgets, Budgetary Organization, Ministries, Independent Agencies, Kosovo.

Falenderimi

Përfundimi i këtij punimi me rëndësi madhore për mua, u bë edhe falë mbë shtetjes së shumë individëve dhe institucioneve, të cilëve u jam shumë mirënjohës. Fillimisht, falënderojmë Univerzitetin “Isa Boletini”, si dhe stafin akademik posaqërisht në Fakultetin Ekonomik, që më mundësuan studime të dinjitetshme.
Gjithashtu falënderoj nga zemra të gjithë kolegët e mi studentë, me të cilët ndamë brengat dhe shqetësimet tonaq, por edhe përjetuam momentet më të bukura dhe më të sinqerta, gjatë këtyre tri viteve të studimeve.
Me këtë rast, veçanërisht dua ta falënderoj Prof. Asoc. Dr. Qazim Tmava, në cilësinë e mentorit të punimit, i cili në çdo kohë, më mbështeti pa rezervë dhe pa kushte. Përzemërsisht e falënderoj dhe njëherit ndihem tejet i privilegjuar që m`u dha mundësia që të bashkëpunoj në këtë projekt me rëndësi shumë të madhe për mua.

Në fund , gjithsesi dua që të shpreh mirënjohjen e thellë për Familjen time, e cila më mbështeti dhe më dha kurajo, në mënyrë që ky punim diplome të kurorëzohet me sukse.

Andaj, nga zemra, **faleminderit të gjithëve**!

Përmbajtja

I. Hyrje .....
1.1 Veshtrim historik mbi buxhetin .....
1.2 Buxheti i Republikës së Kosovës .....
1.3 Funksionet e Buxhetit .....
1.4 Principet e Buxhetit .....
1.5 Ministria e Financave- Departamenti i Buxhetit .....

II. Planifikimi i Buxhetit .....
2.1 Procesi i Planifikimit ë Buxhetit .....
2.2 Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës .....

III. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve .....
3.1 Çka është Korniza Afatmesme e Shpenzimeve .....
3.2 Fazat në hartimin e KASH-it .....
3.2.1 Parashikimi makroekonomik .....
3.2.2 Linjat bazë të sektorëve .....
3.2.3 Lidhja e buxhetit vjetor dhe KASH-i .....
3.3 Korniza Afatmesme e Shpenzimeve .....

IV. Korniza Makroekonomike .....
4.1 Zhvillimet e fundit në Ekonomi .....
4.2 Skenari makroekonomik afat-mesëm .....

V. Korniza Fiskale .....
5.1 Strategjia e politikave dhe objektivat afat-mesme .....
5.2 Ekzekutimi i Buxhetit në vitin 2016 .....
5.3 Përspektiva buxhetore afat mesme .....
5.3.1 Projektimi afatmesëm i të hyrave 2017-2019 .....
5.3.2 Shpenzimet e buxhetit sipas kategorive ekonomike .....
5.4 Potencialet zhvillimore dhe rreziqet fiskale për periudhën 2017-2019 .....
5.4.1 Potencialet zhvillimore .....
5.5 Rreziqet fiskale .....
5.5.1 Rreziku sistematik (makroekonomik) .....
5.5.2 Rreziqet specifike (nga politikat) .....
5.5.2.1 Rreziqet fiskale jashtë-buxhetore .....
5.6 Korniza e Shpenzimeve Sektoriale 2017-2019 – Qeveria Qëndrore .....

VI. Niveli Komunal .....
6.1 Financimi Komunal .....
6.2 Burimet e Financimit Komunal për vitin 2017-2019 .....
6.2.1 Granti i Përgjithshëm për vitin 2017, 2018,2019 .....

6.2.2 Granti specifik për Arsim parauniversitar për vitin 2017 .....
6.2.3 Granti specifik për Shëndetësi primare për vitin 2017.....
6.2.5 Përmbledhje e financimit komunal për 2017-2019.....
6.3 Komisioni i Granteve .....
6.4 Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për komuna 2017-2019.....

VII. Përgatitja e Propozim-Buxhetit.....
7.1 Kufijtë Buxhetorë .....
7.2 Qarkoret buxhetore.....
7.3 Sistemet për planifikim të buxhetit.....
7.4 Institucionet Ndërkombëtare Financiare dhe të tjera.....

VIII.Dorëzimi i Propozim-buxhetit dhe Aprovimi .....
8.1 Dorëzimi i Propozim-buxhetit.....
8.2 Aprovimi i Buxhetit.....
8.3 Ekzekutimi i Buxhetit .....
8.4 Baza Ligjore .....

IX. Konkluzionet .....
9.1 Rekomandimet.....
9.2 Literatura .....

Lista e Tabelave

Pjesëmarrja e mallrave të eksportuara në eksportin total

Struktura e të hyrave buxhetore

Struktura e shpenzimeve

Deficiti i përgjithshëm buxhetor dhe financimi

Agregatet kryesor makroekonomik

BPV nominale dhe komponentët e tij

Te hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme buxhetore

Përcaktimi i shumës së Grantit të Përgjithshëm për komuna për 2017-19

Struktura e Grantit të Përgjithshëm për vitin 2017 dhe parashikimet 2018-2019

Granti i Përgjithshëm për vitin 2017 dhe parashikimet 2018-2019

Granti i Përgjithshëm sipas viteve 2014-2019

Shpërndarja e grantit specifik për Arsim parauniversitar për vitin 2017

Granti për arsim parauniversitar sipas viteve 2014-2019

Numri i nxënësve sipas viteve 2009-2017
Granti specifik për Shëndetësi primare në vite 2014-2019
Projeksionet e të Hyrave vetanake komunale për vitin 2017-2019
Të hyrat vetanake të realizuara nga komunat në vitet 2013-2016
Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2017-2019 për komunat
Struktura e shpenzimeve për buxhetin komunal për vitin 2017-2019

Lista e Figurave

Struktura organizative e Ministrisë së Financave
Rritja reale e BPV-së, në %
Struktura e BPV-së, në vlera nominale
Pjesëmarrja e komponentëve në PBV
Struktura e tatimeve direkte si % e BPV-së
Struktura e tatimeve indirekte si % e BPV-së
Stoku i Borxhit të Përgjithshëm dhe si përqindje e BPV-së
Pjesëmarrja e financimit komunal në buxhetin e përgjithshëm 2014-2019
Ecuria e granteve qeveritare komunale sipas viteve 2014-2019 (mil.€)
Struktura e shpenzimeve Komunale për vitin 2017 (në %)
Orari për planifikim dhe buxhetim në Qeverinë e Kosovës

Lista e shkurtesave

AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
BB	Banka Botërore
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BPV	Bruto Produkti Vendor
BP	Bilanci i pagesave
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
DPEP	Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Publike
UE	Unioni Evropian
MF	Ministria e Financave
LFPL	Ligji i Financave të Pushtetit Lokal
KASH	Korniza Aftmesme e Shpenzimeve
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Informacionit
TVSH	Tatimi i Vleres se Shtuar
ICK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IFN	Institucionet Financiare Ndërkombëtare
IHD	Investimet e Huaja Direkte
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
TI	Teknologjia Informative

I. Hyrje

1.1 Veshtrim historik mbi buxhetin

Fjala buxhet rrjedh nga anglishtja dhe frëngjishtja mesjetare, "bougette", që do të thotë *thes lëkure*. Në kete periudhe, Kancelari i Thesarit mbretror sillte ne parlamentit anglez thesin e lëkurës në të cilin gjendeshin propozimet për të ardhurat dhe shpenzimet nacionale, për periudhën në vazhdim, periudhe e cila ishe zakonisht njevjecare.

Pikënisja e cdo buxheti eshte buxheti familjar. Çdo individ apo familje, i planifikon shpenzimet në bazë të mjeteve që ka në dispozicion, apo një familje e llogarit koston e jetesës së saj sipas një buxheti – të hyrat që ka dhe të cilat mund t'i shpenzojë për gjërat elementare sikurse janë: të ushqyerit, veshëmbathja, pagesa për qira, shpenzime te komunalive, argëtim, rekracion, etj. Ky plan bëhet për periudha të caktuara për shembull, shpenzimet e familjes llogariten për një periudhë 15-ditëshe apo për një muaj.

Në të njëjtën mënyrë, edhe qeveria i planifikon shpenzimet e saj në varësi të buxhetit që harton dhe në dispozicion. Se kendejmi, ajo planifikon se sa nga të hyrat e saj do të shpenzohen për nevoja të ndryshme të shtetit si për shembull, për pagat e të punësuarëve në sektorin publik, për shpenzime operative të institucioneve publike, shpenzimet për arsim, shëndetësi, pensione, zbutje të varfërisë, shpenzime kapitale, rritjen e mirëqenies së qytetarëve, zhvillimin e ekonomisë, etj.

Ndryshe nga buxheti familjar, buxheti i shtetit planifikohet për një periudhë të caktuar, zakonish nje vit dhe quhet "vit buxhetor". Ky vit përbëhet nga 12 muaj dhe sipas standardeve të vendosura në vendin tonë është i njëjtë me vitin kalendarik, pra fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor (në disa vende ky vit shtrihet në periudhën shtator - tetor i vitit të ardhshëm ose mars - prill i vitit tjetër).

Procesi i planifikimit, përgatitjes, paraqitja dhe aprovimi i buxhetit të shtetit përcaktohet permes legjislacionit në fuqi. Ky proces, kërkon kohë dhe kapacitet, është gjithëpërfshirës dhe mjaft kompleks. Por, duhet te jete transparent, publik dhe ligjor, si dhe në interest ë qytetarëve dhe publikut, duke u mbështtetur në analizat për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit dhe i përputhshem me politikat strategjike të qeverisë.

Buxheti i Qeverisë, është mishërim i autorizimit ligjor nga dega legjislative në planin e shpenzimeve të vendit për vitin fiskal. Shuma e ndarë buxhetore duhet të varet nga të hyrat që janë

në dispozicion. Buxheti duhet të jetë një instrument për caktimin e prioriteteve dhe për alokimin e resurseve financiare, si dhe për arritjen, kontrollimin dhe monitorimin e tyre, për të siguruar që ato i plotësojnë objektivat e deklaruara nga Qeveria.

Buxheti *është i balancuar në kuptimin e të hyrave dhe të dalave.* Të hyrat dhe të dalat e qeverisjes së përgjithshme kryhen nëpërmjet llogarisë së unifikuar të thesarit, e mbajtur në euro. Llogaria e unifikuar e thesarit mbahet në Bankën Qendrore.

Të hyrat përfshijnë të hyrat që rezultojnë nga transaksione të ndërsjella dhe jo të ndërsjella, të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve, nga shitja e aktiveve afatgjata, të ardhurat nga tatimet, taksat dhe tarifat, nga shfrytëzimi i aktiveve në pronësi shtetërore, nga grantet nga të tretët, nga kontributet e detyrueshme, nga interesat, nga huatë, nga transaksionet financiare, etj.

Të dalat përfshijnë shpenzimet që lidhen me transaksione të ndërsjella dhe jo të ndërsjella, shpenzime për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, për blerjen ose formëzimin e aseteve afatgjata, pagesa për huamarrje, transferta qeveritare, grante dhënë të tretëve, kontribute dhe donacione, pagesa financiare dhe të principaleve të borxhit, shpenzime për interesa, shpenzime për qira financiare, etj.

Buxheti analizohet në funksion të klasifikimeve buxhetore si më poshtë:

a**) klasifikimi administrativ**, i cili përfshin klasifikimin e njësive të qeverisjes së përgjithshme deri në nivelin më të ulët të njësisë shpenzuese;

b) **klasifikimin ekonomik,** i transaksioneve sipas natyrës dhe / ose sektorit ekonomik;

c**) klasifikimi funksional**, sipas funksioneve ose objektivave ekonomiko-socialë, që njësitë e qeverisjes së përgjithshme synojnë të përmbushin;

ç) **klasifikimin sipas programeve**, i cili përfaqëson programet, nënprogramet dhe projektet, në përputhje me objektivat e njësive të qeverisjes së përgjithshme;

d) **klasifikimin sipas burimeve të financimit**

Siq e theksua me siper, buxheti duhet te jete i balancuar në aspektin e të hyrave dhe të dalave. Mirepo, ka raste ne praktike kur nuk kemi gjendje ekuilibruese dhe na paraqiten situatata te buxhetit deficitar, perkatesisht buxhetit suficitar.

Deficiti buxhetor, në një vit buxhetor, është diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, kur shpenzimet janë më të mëdha se të ardhurat.

Suficiti buxhetor, në një vit buxhetor, është diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, kur të ardhurat janë më të mëdha se shpenzimet.

Deficiti i buxhetit të shtetit financohet nga huatë e brendshme ose të huaja dhe, si rregull, masa e tij nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara në ligjin e buxhetit vjetor.

1.2 Buxheti i Republikës së Kosovës

Buxheti i Republikës së Kosovës paraqet shumën e lejuar me ligj e cila u vihet në dispozicion për shpenzim nga Fondi i Kosovës për një program apo qëllim specifik apo, aty ku nuk është identifikuar qëllimi specifik, për një kategori të shpenzimeve të një organizate buxhetore, si është e paraparë me Ligjin Vjetor për Buxhetin.

Ligji bazik për Buxheti e Republikës së Kosovës është Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive Nr. 03/L-048 i vitit 208, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221 në korrik të vitit 2010. Ndërsa, për çdo vit nxirret Ligji Vjetor I Buxhetit, që përcakton Buxhetin vjetor të Rrpublikës së Kosovës.

Ligji Vjetor i Buxhetit, përveç dispozitave ligjore të përcaktuar përmban edhe tabelat konkrete *(Tabela Nr. 1, që paraqet Të hyrat dhe Shpenzimet e përgjithëshme, Tabela 2, paraqet Përmbledhjen e Ndarjeve Buxhetore sipas kategorive ekonomike për Organizatat Buxhetore, Tabela 3.1 dhe 4.1 paraqet shpenzimet operative, Tabela 3.2 dhe 4.2 paraqet Projektet kapitale).*të cilat paraqesin të dhënat për vitin paraprak, vitin aktual dhe tre vitet e ardhme (ku viti i parë paraqet vitin buxhetor, ndërsa dy vitet tjera janë vlerësime).

Për t'u kuptuar, me termin Organizatë Buxhetore nënkuptojmë të gjitha Ministritë, Komunat apo Agjencitë të cilat pranojnë ndarje buxhetore nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës sipas Ligjit Vjetor të Buxhetit. Buxheti i paraparë për Ministritë, Agjencionet e Pavarura (të cilat janë të themeluara sipas Kushtetutesë apo me ligj) dhe për komunat, i konsoliduar, paraqet Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Ne vijim, prezantojme **hapat-proceduren e Planifikimit të Buxhetit:**

- Komisioni i Granteve,
- Kornizë Afatmesme të Shpenzimeve (30 prill).
- Qarkorja e parë buxhetore e cila përmban udhëzimet për procesin buxhetor, kufijtë buxhetor, kalendarin buxhetor (15 maj).

- Dorëzimi i kërkesave buxhetore nga Organizatat Buxhetore, në MF,
- Qarkore e dytë buxhetore e cila adreson vetëm çështjet specifike të cilat kanë rezultuar pas lëshimit të Qarkores së parë buxhetore,
- Dëgjimet buxhetore,
- Konsultime në Qeveri për caktimin e kufijve final buxhetore (shtator),
- Nxjerrja e Qarkores së tretë buxhetore me kufijtë final buxhetor (shtator),
- Aprovimi finalizimi dhe dorzimi i buxhetit në MF (përmes BDMS dhe PIP nga niveli Qendror),
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Projektligjit të Buxhetit vjetor përkatësisht Draft Buxhetit në Qeveri (tetor),
- Shqyrtim dhe aprovim i Pojektligjit për Buxhetin vjetor të Republikës së Kosovës nga Kuvendi i Republikës së Kosovës- leximi i parë (nëntor-dhjetor),
- Aprovimi i Ligjit vjetor të Buxhetit të Republikës së Kosovës- leximi i dytë (dhjetor),
- Amandamentimi i Ligjit vjetor të Buxhetit të Republikës së Kosovës nga Presidentja.

1.3 Funksionet e Buxhetit

Në vitet e para, për shkak të specifikave dhe zhvilimit të tij, kur dihet se kryesisht ka qenë një buxhet i varur prej burimeve te financimit të jashtem, buxheti ka pasur funksionin neutral. Meqenëse, në ekonominë moderne buxheti eshte bërë instrument shumë me rëndësi po ashtu edhe Buxheti i Republikës së Kosovës, sot e ka një funksion të tillë. Duke kuptuar, se nëpermjet buxhetit bëhet rishpërndarja dhe shpenizimi i një pjese shumë të madhe të te ardhurave nacionale, për këtë arsye aktualisht buxheti nuk mund të ketë rol neutral, por anasjelltas, është me ndikim shumë të madh madje edhe vendimtar në zhvillimin ekonomik.

Më poshtë di ti specifikojme disa nga funksionet kryesore të buxhetit.

Funksioni ekonomik - përfshin përcaktimin e të dalave dhe të hyrave publike me të cilat do te mbulohen këto shpenzime publike. Në vitet e fundit, për çdo vit është në rritje dhe po vie në shprehje funksioni ekonomik i buxhetit, duke e fuqizuar ate si një instrument të rëndësishëm të shtetit për intervenim në zhvillimin ekonomik si dhe politika sociale. Në këtë drejtim, buxheti ndikon në drejtimin e rrjedhjeve ekonomike, përmirësimin e mjedisit investues dhe përkrahjen e

sektorit afarist, zhvillimin e infrastrukturës, revitalizimin e sektorit të bujqësisë, zhvillimin e kapitalit njerëzor, zvoglimin e papunësisë, etj.

Funksioni politik - Kuvendi i Republikës së Kosovës është Organ që e aprovon buxhetin. Buxheti për çdo vit aprovohet si Ligj vjetor i buxhetit për vitin përkatës, sepse pa lejimin (aprovimin) e buxhetit nuk mund te kryehen funksionet e shtetit. Kjo pra paraqet funksionin politik te buxhetit. Nga aspekti politik duhet shqyrtuar edhe metoden e nxjerrjes dhe te aprovimit te buxhetit, kontrollimin e buxhetit, realizimin e buxhetit, etj., të cilat janë të përcaktuar me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive, Ligjin vjetor të Buxhetit, Rregullat financiare të Thesarit, si dhe legjislacion tjetër përkatës.

Funksioni juridik - ka të bëj me të drejten buxhetore të shtetit. Nëpërmjet buxhetit krijohen marrdheniet në mes te organeve te shtetit në nje ane, dhe te personave fizik dhe juridik në anën tjetër. Dhe këto marrdhënie rregullohen me legjislacionin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive si dhe legjislacion përkatës për përgatitjene dhe hartimin, nxjerrjen, realizimin dhe kontrollimin e buxhetit.

1.4 Principet e Buxhetit

Principet e buxhetit paraqesin rregullat themelore të cilave duhet permbajtur gjatë përgatitjes, aprovimit dhe ekzekutimit të buxhetit. Në praktikën e financave ekzistojne shumë principe buxhetore, por Buxheti i Kosovës përveç tjerash i atribohen këto principe, si më të rëndesishme:

i). Principi i gjithmbarshem i buxhetit – te gjitha te hyrat dhe te gjitha te dalat publike paraqiten në një tërësi te përbashkët dhe atë ne nje buxhet. Principi i gjithëmbarshëm i buxhetit, do te thotë ekzistimi i një buxheti unik (i përbashkët) pë tërë shtetin.

ii). Principi i plotë i buxhetit – Principi i plote i buxhetit kerkon qe ne buxhet te paraqiten te gjitha te hyrat dhe te dalat publike ne shuma te plota. Ky princip gjenë shprehje në Buxhetin e Kosovës. Buxheti paraqitet sipas principit bruto, qe don te thote se te hyrat dhe te dalat buxhetore te jene te dhena ne shuma te plota pa kurrfar zbritjesh (pa kompenzimin e shumave).

iii). Principi i qartësise se buxhetit – Principi i qartesise se buxhetit kerkon qe te hyrat dhe te dalat ne buxhet te ndahen ne grupe dhe atë te hyrat sipas burimeve kurse te dalat sipas qellimit te shpenzimit.

iv). Principi publik i buxhetit – Principi publik i buxhetit ka te bej me njoftimin e obliguesve tatimore dhe te qytetareve te tjere per lartësinë e mjeteve buxhetore, per llojin e te hyrave dhe per qellimin e shpenzimit te tyre.

v). Principi njëvjeqar i buxhetit – Principi 1 vjeqar i buxhetit ka të bëj me atë se buxheti si plan i të hyrave dhe te dalave te shtetit, eshte ngusht i lidhur me periudhen e caktuar.

vi). Principi i saktësisë së buxhetit – Principi i saktësisë se buxhetit bazohet ne supozimin se te hyrat dhe te dalat buxhetore duhet te caktohen ne menyre sa me reale, ne menyre qe te mos paraqiten devijime te medha gjate realizimit te buxhetit.

1.5 Ministria e Financave -Departamenti i Buxhetit si pjese vitale e saj

Sipas te dhenave zyrtare te Departamentit të Buxhetit, *objektivi themelor i buxhetit te shtetit është stabiliteti social dhe zhvillimi ekonomik përmes një buxheti që rrit efikasitetin dhe efektivitetin dhe ofron rezultate të paanshme sociale dhe është i qëndrueshëm sa i përket burimeve të mundshme*. Që të arrihet ky rezultat, synimi i Departamentit të Buxhetit është të menaxhojë një proces buxhetor vjetor efikas dhe efektiv dhe të ofrojë këshilla cilësore për Qeverinë në të gjitha aspektet e politikave fiskale dhe strategjive sektoriale.

Përgjegjësitë dhe aktivitetet e Departamentit të Buxhetit, janë:

- Përmirësimi dhe koordinimi i formulimit të politikave për të siguruar një lidhje më të mirë midis politikave dhe alokimit të burimeve si dhe një transparencë më të lartë në procesin e hartimit të buxhetit të shtetit
- Rritja e efiçencës së shpenzimeve publike dhe disiplinës fiskale në procesin e zbatimit të buxhetit të shtetit
- Përmirësime në sistemin e buxhetit dhe në procedurat buxhetore,
- Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe modernizimi i sistemit buxhetor,
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve,
- Përgatitja e propozim Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës

1.6 Procesi i Planifikimit të Buxhetit

Praktikat më të mira ndërkombëtare të përgatitjes dhe aprovimit të buxhetit bazohen kryesisht në dokumentet strategjike dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore (të shpenzimeve), për të arritur te një proces i buxhetit vjetor të buxhetit më transparent, i bazuar në dokumente strategjike dhe në pajtim me prioritet e përcaktuara. Konsolidimi i këtij procesi ofrojnë bazën për procesin e mirëfillt vjetor buxhetor. Çdo qeveri efektive duhet të veprojë në kuadër të një kornize të gjithmbarshme në të cilën përcaktohen politikat dhe prioritetet afatgjate dhe afatmesme, dhe e cila i ndan resurset sipas politikave dhe prioriteteve të tilla në mënyrë që të sigurojë të ardhme të mirë për qytetarët e qeverisë së tillë. Dokumentet strategjike kryesisht kidhen me mandatin e qeverisë.

Nëse i referohemi këtij procesi, se si ka qenë dhe është aktualisht, vërejmë se Kosova ka shënuar një arritje dhe progres në vitet e fundit në krahasim me proceset e zhvilluara para vitit 2008.

Mbi bazën e dokumenteve të paraqitura më poshtë është planifikuar Buxheti i Republikës së Kosovës:

- **Programi i Qeverisë 2015-2018,**
- **Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021**
- **Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2017-2019**.

1.7 Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, e cila duhet të bazohet në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik, si dokumenti Srategjik është gjithashtu edhe proces, edhe dokument për planifikimin buxhetor. Me fjalë të tjera, KASH-i i lidh proceset "lart-poshtë të politikëbërjes dhe caktimit të prioritetit me proceset "poshtëlart"të formulimit të buxhetit, dhe një gjë e tillë bëhet me projeksione afatmesme (zakonisht trevjeçare) të të hyrave, shpenzimeve dhe trendëve (demografia, ndryshimet politike, etj.) të cilat mund të kenë ndikim në aktivitetet e nje Programi.

Në rastin e Kosovës, në mungesë të një Strategjie të mirëfillt, këtë rol e luajnë Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Plani i Veprimit të Vizionit Ekonomik të Kosovës

Duke u nisur nga praktikat e mira e vendeve të zhvilluara dhe me një përvojë të dëshmuar e që ka prodhuar një proces të mirë buxhetor dhe Buxhet të mbështetur në Strategji dhe dokumente

strategjike vërejmë se Kosovës kjo ende i mungon, Kosova vazhdon të mos ketë të aprovuar Planin e Zhvillimit Ekonomik, si dokument strategjik për të përgatitur dhe aprovuar KASH-in dhe Buxhetin vjetor.

Nëse analizojmë dokumentet që i paraprijnë procesit dhe sistemit buxhetor aktual në Kosovë, sikurse janë Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Plani i Veprimit të Vizionit Ekonomik të Kosovës, do të vërejmë disa fakte që e vështirësojnë procesin buxhetor. Programi, si dokument strategjik katër vjeqar, paraqitet gjithëpërfshirës në përcaktimin e Prioriteteve, i cili do të paraqes edhe vështirësi me rastin e përgatitjes së KASH-it por edhe të Buxhetit vjetor.

Gjithashtu këto dokumente strategjike që Kosova bazohet për procesin buxhetor vjetor, duhet aanlizuar se sa janë të qëndrueshme, të realizueshme, reale dhe të sakta, sepse të gjitha këto elemente do të kenë ndikim edhe në mbarëvajtjen dhe paraqitjen e një procesi të rregullt buxhetor vjetor.

Nëse analizojmë dokumentet shumëvjeqare të Kosovës, KASH-it dhe Buxhetit Vjetor, del se, kemi shumë shmangie, mospajtueshmëri, shpeshherë jo të mbështetura me buxhet vjetor, apo mospajtueshmëri në mes Prioriteteve dhe Buxhetit.

Siç është thënë, përpilimi i KASh-it përcaktohet me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (në vijim LMFPP) dhe aty jepet skica e përmbajtjes së domosdoshme.

Kjo pjesë e Udhëzuesit për Procesin e Planifikimit dhe Buxhetit në Kosovë është në harmoni me kërkesat e LMFPP-së. Udhëzimet për përgatitjen e KASh-it nxirren për çdo vit nga Ministria e Financave (MF).

Buxhetet qeveritare përgatiten sipas ciklit vjetor, por që ato të jenë të formuluara mirë dhe t'i kontribuojnë kualitetit të lartë dhe shërbimeve të qëndrueshme, duhet të marrin parasysh ngjarjet jashtë ciklit vjetor, posaçërisht realitetet makroekonomike, të hyrat e pritura dhe nevojat afatgjate të programeve dhe politikave shpenzuese qeveritare. Një pikëpamje afatmesme po ashtu është e nevojshme për shkak se afati kohor i buxhetit është zakonisht shumë i shkurtër për qëllim të përshtatjes së prioriteteve në shpenzim. Në kohën kur hartohet buxheti, shumica e shpenzimeve të vitit buxhetor tashmë janë zotuar. Për shembull, pagat e personelit të përhershëm civil, pensionet që duhet t'u paguhen të pensionuarve, kostoja e shërbimeve të borxheve dhe të ngjashme, nuk ndryshojnë në afate të shkurtra. Në shumicën e vendeve të zhvilluara, margjina e manovrimit është zakonisht rreth 5 deri në 10 % të shpenzimit të përgjithshëm. Kjo është arsyeja që buxhetimi vjetor

nuk mund të bëhet në izolim, por duhet të lidhet me planifikim dhe kontekst të kornizës shumëvjeçare.

Parashikimet shumëvjeçare rrotullohen çdo vit. Viti i parë është plotësisht në përputhje me buxhetin vjetor, përderisa parashikimet e shpenzimeve për vitet vijuese duken të jenë indikativ. Periudha e planifikimit është zakonisht tre deri në pesë vite. Përderisa në disa vende përgatitja e parashikimeve shumëvjeçare është bërë pjesë integruese e hartimit të buxhetit vjetor dhe shihet si instrument kyç i kontrollit të shpenzimeve.

Një KASH i zbatuar mirë duhet:

• Të lidhë prioritetet e Qeverisë me buxhetin brenda një pakoje të qëndrueshme të shpenzimeve;

• Të theksojë kompromiset në mes të objektivave garuese të Qeverisë;

• Të lidhë buxhetet me zgjidhjet e politikave të bëra; dhe

• Të përmirësojë rezultatet duke rritur transparencën, llogaridhënien dhe parashikueshmërinë e financimit.

Përveç pakos së mjeteve nga lart-poshtë, KASH-i përbëhet edhe nga vlerësimi poshtë-lart i shpenzimeve afatmesme dhe atyre të politikave ekzistuese, dhe në fund të fundit përmbushja e këtyre shpenzimeve bëhet me mjetet që janë në dispozicion në kontekst të procesit të buxhetit vjetor. Pakoja e mjeteve nga lart-poshtë është krejtësisht një model makroekonomik që tregon caqet fiskale dhe parashikon të hyrat dhe shpenzimet, përfshirë edhe obligimet financiare të Qeverisë në kosto të lartë të programeve mbarëqeveritare.

1.8 Fazat në hartimin e KASH-it

Ekzistojnë tri faza në hartimin e KASH-it, dhe ato do të përshkruhen më poshtë. Ato janë:

• ***Parashikimi makroekonomik***

• ***Linjat bazë sektoriale dhe***

• ***Lidhja e buxhetit vjetor dhe KASH-i***

1.8.1 Parashikimi makroekonomik

Para se të ndërmerret çfarëdo planifikimi afatmesëm, është e rëndësishme të dihet parashikimi i mjeteve të cilat janë në dispozicion për vitin brenda të cilit do të implementohet KASH-i.

Parashikimi makroekonomik duhet të përgatitet në bazë të informatave në dispozicion, dhe përgatitja e këtyre parashikimeve duhet të bëhet në mënyrë të përsëritur. Një pako e objektivave "fillestare" makroekonomike duhet të definohet kur të hartohet KASh-i i parë në vit, për të themeluar skenarin fillestar referues, por korniza vjetore përfundimtare e KASh-it kërkon bashkërendimin dhe konvergjencën progresive për të gjitha objektivat dhe qëllimet që merren parasysh gjatë vitit.

Përgatitja e Kornizës Afatmesme Makroekonomike duhet të jetë aktivitet i vazhdueshëm përgjatë vitit. Korniza duhet të përgatitet në fillim të secilit cikël buxhetor, në mënyrë që t'u japë udhëzime adekuate ministrive kyçe. Atëherë duhet të azhurnohet gjatë fazave të mëtejshme të përgatitjes së buxhetit, në mënyrë që të marrë parasysh ndryshimet në ambientin ekonomik dhe fiskal. Gjatë fazës së ekzekutimit të buxhetit, projeksionet makroekonomike po ashtu kërkojnë azhurnime të shpeshta, në mënyrë që të vlerësojnë ndikimin e ndryshimeve nga jashtë ose rrëshqitje të mundshme në zbatimin e buxhetit.

1.8.2 Linjat bazë të sektorëve

Duhet të theksohet që aktualisht procesi i Kosovës për t'u përqendruar ose menaxhuar sektori publik sipas sektorëve është ende në evoluim e sipër. Pavarësisht, shumica e qeverive kanë gjetur se përqendrimi në sektorë është qasje e mirë e caktimit të politikave dhe ndarjes së resurseve, dhe se ka gjasa që sistemet e planifikimit dhe buxhetimit në Kosovë do të evoluojnë.

Kosova ndarjen e fondeve e bën në bazë të organizatave buxhetore, janë disa kategori të standardizuara të sektorit publik, drejt të cilave fokusohet vëmendje e konsiderueshme, kjo përfshin shëndetësinë, edukimin dhe kategoritë e tjera.

1.8.3 Lidhja e buxhetit vjetor dhe KASH-i

Kosova ka themeluar procese buxhetore të cilat janë zhvilluar gradualisht për të integruar buxhetimin vjetor dhe atë shumëvjeçar. Këto procese përfshijnë:

- Parashikimet shumëvjeçare përgatiten një vit më herët si pikënisje e procesit të përgatitjes së buxhetit. MF-i azhurnon parashikimet shumëvjeçare të përgatitura një vit më herët, duke marrë parasysh zhvillimin e parametrave ekonomikë, ekzekutimin e buxhetit dhe shqyrtimin e shpenzimeve.
- Kufijtë sektorialë mund të caktohen çdo vit të buxhetit shumëvjeçar, në bazë të politikave ekzistuese të Qeverisë dhe ndryshimeve të propozuara në politika. Buxheti vjetor dhe parashikimet shumëvjeçare përgatiten nën këto shtrëngesa të mëdha buxhetore;
- Politikat në vazhdim e sipër janë qartë të ndara nga politikat e reja të propozuara dhe nga ndryshimet në politika.

KASH përmbane:

- parshikimet makro ekonomike dhe fiskale për periudhen e caktuar;
- një dekleratë të prioriteteve të politikave të qeverisë që ka për qëllim orientimin e ndarjes së mjete buxhetore gjatë procesit të ardhshëm buxhetor;
- parashikimin e te hyrave dhe një plan të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore sipas ketegorive ekonomike, si dhe suficitin ose deficitin rezultues fiskal për secilin vit;
- parashikime të borxhit të brenshëm dhe të jashtëm dhe parashikimin për kthimin e borxheve;
- trendin e investimeve kapitale të cilat finacohen nga buxheti si dhe një vlerësim të volumit të tyre për Periudhën Buxhetore të KASH;
- politikën e pagave dhe punësimin për Periudhën Buxhetore të KASH;
- trendët e fomamcimit dhe shpenzimit për secilën organizatë buxhetore
- grantet qeveritare për secilën komuna sipas formulës së përcaktuar në LFPL.

Gjithashtu pjesë e KASH-it janë edhe Projektet e bashkëfinacuara (projektet me financim të përbashkët nga Buxheti Kosovës dhe donatorët), obligime dhe Veprimet e Planit për Partneritet Europian, si dhe projektet e zotuara për financim nga donatorët.

1.9 Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitin 2017-2019

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitin 2017-2019 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit hartohet buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofrojë një analizë të bazuar të mjedisit makroekonomik në vend, për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë.

Në fillim të vitit 2015, Qeveria e Republikës së Kosovës aprovoi Programin e Qeverisë, në të cilin janë paraqitur prioritetet e politikave për vitet në vijim. Rrjedhimisht, Programi i Qeverisë është dokumenti mbi bazën e të cilit u hartua edhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Programi për Reforma në Ekonomi. Përgatitja e këtij dokumenti është tërësisht në linjë me këto dokumente strategjike të Qeverisë, duke përfshirë edhe Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

Viti 2015 u karakterizua me një rritje të kënaqshme ekonomike e mbështetur kryesisht nga reformat në politikat tatimore dhe ato për përmirësimin e ambientit të të bërit biznes të ndërmarra gjatë vitit 2015. Perspektiva afatmesme pritet të karakterizohet me një rritje mesatare prej 4%, ku përveç investimit dhe konsumit, diversifikimi i eksportit të mallrave pritet të kontribuoj në një rritje më të qëndrueshme.

Shtylla kryesore e programit qeverisës është zhvillimi ekonomik, punësimi dhe ngritja e mirëqenies së popullsisë, e përcjellë me prioritetet tjera jo më pak të rëndësishme, siç janë sundimi i ligjit, arsimi dhe shëndetësia, dhe integrimet evropiane. Nga politikat e reja, përveç tjerash, vlen të përmendet se gjatë kësaj periudhe Qeveria planifikon të filloj implementimin e skemës së sigurimit shëndetësor konform Ligjit për Shëndetësi dhe Ligjit për Sigurimet Shëndetësore tashmë të aprovuara.

Gjithashtu, në periudhën e ardhshme theks të veçantë do t'i kushtohet të ashtuquajturës klauzolë të investimeve përmes së cilës Qeveria e Republikës së Kosovës synon të investoj në projektet e mëdha infrastrukturore për të tejkaluar sfidat strukturore të cilat kanë penguar shfrytëzimin maksimal të potencialit zhvillimor të vendit

Për të mundësuar një rritje gjithëpërfshirëse ekonomike në vend, Qeveria ka rritur hapësirën për shpenzime kapitale në nivel të komunave. Përmes kësaj, Qeveria synon t'i jap më shumë fleksibilitet qeverisjes lokale të investoj në projektet që komunat i identifikojnë si më të rëndësishme për zhvillimin regjional të Kosovës.

KASH 2017-2019 është e strukturuar në katër pjesë kryesore:

- Pjesa e pare përfshin Deklarata Afatmesme e Prioriteteve e cila ofron një përmbledhje të gjerë të prioriteteve të Qeverisë në përputhje me programin qeverisës dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim;
- Pjesa e dytë përfshin Projeksionet makro-fiskale të bazuar në parametrat e përgjithshëm të zhvillimit ekonomik;
- Pjesa e tretë dhe të katërt përfshin Parashikimet fiskale të cilat përcaktojnë kufijtë e gjerë të shpenzimeve mbi bazën e të cilave përgatitet më vonë Buxheti Qendror dhe ai Komunal.
- ,

II. Korniza Fiskale

2.1 Strategjia e politikave dhe objektivat afat-mesme

Qeveria vazhdon të ketë si objektiv kryesor të politikës fiskale mirëmbajtjen e pozicionit të qëndrueshëm fiskal dhe menaxhimin financiar publik në mënyrë të përgjegjshme, meqenëse është edhe një nga rekomandimet që dalin nga Raporti i fundit të Progresit dhe PRE-të e mëparshme. Për të ruajtur këtë angazhim, Qeveria ka miratuar rregullin fiskal, i cili kufizon nivelin e përgjithshëm të deficitit në 2% të BPV-së. Duke pasur parasysh marrëdhënien që Kosova ka me FMN-në, si një nga partnerët kryesorë në drejtim të hartimit të kornizës makro-fiskale brenda marrëveshjes aktuale Stand-by, Kosova në mënyrë të konsiderueshme e ka kufizuar hapësirën në të cilën ajo mund të akomodojë politikat e përcaktuara në programin e Qeverisë. Pasi që Kosova nuk karakterizohet nga ndonjë bilanc i konsiderueshme fiskal dhe të rreziqeve të pagesave dhe nuk ka politika monetare, ky program ka një fokus të veçantë në stimulimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike të vendit.

Të pengesat ekzistuese të larta strukturore me të cilat përballet ekonomia kanë bërë që Qeveria të ndryshojë LMFPP-në për të miratuar klauzolën e investimeve, e cila lejon bërjen e shpenzimeve për projekte të financuara nga IFN të cilat simulojnë rritjen (më shumë detaje janë përshkruar Kutinë 3). Në këtë linjë, Qeveria është e angazhuar të zbatojë agjendën e reformave strukturore të përcaktuara në programin e qeverisë.

Një tjetër mënyrë me të cilën Qeveria planifikon të trajtojë vështirësitë në prodhimin lokal janë stimujt fiskal. Ministria e Financave, duke qenë një prej institucioneve kryesore në krijimin dhe promovimin e politikave më të favorshme fiskale, në bashkëpunim me komunitetin e biznesit ka punuar vazhdimisht në hartimin e një pakete të ndryshimeve të politikave tatimore, si një vazhdim i reformave të ndërmarra vitin e kaluar. Si rezultat, është bërë dakordimi për konceptimin e një pakete të re fiskale (Kutia 2 më poshtë) në bazë të kërkesave dhe nevojave të ngritura nga bizneset. Kjo paketë është projektuar për të përmirësuar mjedisin e të bërit biznes, në përpjekje për të forcuar prodhimin vendor dhe krijimin e vendeve të punës në rrugën drejt rritjes së qëndrueshme ekonomike

2.2 Ekzekutimi i Buxhetit në vitin 2016

Buxheti për vitin 2016 është miratuar më 14 dhjetor, 2015 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.[1] Gjatë rrjedhës së vitit, politikat me ndikim fiskal të parashikueshëm ka hyrë në fuqi dhe disa janë ushtruar nga viti 2015. Në prill të vitit 2016, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian hyri në fuqi. Për më tepër, ligji për faljen e borxheve, i cila hyri në fuqi në shtator të vitit 2015, është zgjatur deri në prill 2017, duke i dhënë kështu qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës mundësinë për të aplikuar për faljen e borxhit gjatë vitit 2016.[2] Përveç kësaj, paketa fiskale që hyri në fuqi në shtator të vitit 2015 ka pasur një vit fiskal kohë për të reflektuar ndikimin e saj të plotë në buxhetin qeveritar.[3]

Në krahasim me vitin 2015, politikëbërësit planifikuan edhe të hyra më të mëdha dhe shpenzime më të mëdha për buxhetin e vitit 2016. Tabela e mëposhtme tregon se ky trend rritës pritet të vazhdojë edhe në vitin 2017. Deficiti buxhetor në vitin 2016 ishte 1.6% si përqindje e BPV-së, i cili është i përafruar si me legjislacionin kosovar edhe Marrëveshjen Stand-bz me FMN-në.

[1] http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-071%20sh.pdf
[2] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11017
[3] Ndryshimet kryesore të miratuara përfshijnë rritjen e normës standard të TVSH-së nga 16% në 18% dhe futjen e një normë të reduktuar të TVSH-së prej 8% për mallrat e shumta themelore nga shporta e konsumatorit.

Table 9. të hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme të Qeverisë, *në milionë euro*

Përshkrimi	2015	2016	2017	2018	2019
në milionë euro					
1. TOTALI I TË HYRAVE	**1,470**	**1,634**	**1,725**	**1,793**	**1,892**
2. TOTALI I SHPENZIMEVE	**1,564**	**1,732**	**2,001**	**2,064**	**2,160**
2.1 SHPENZIMET RRJEDHËSE	**1,149**	**1,221**	**1,275**	**1,310**	**1,348**
2.2 SHPENZIMET KAPITALE	**404**	**500**	**722**	**753**	**810**
3. BILANCI PRIMAR	**-94**	**-98**	**-276**	**-272**	**-268**
Pagesa e interesave	-17	-25	-23	-30	-30
4. Bilanci i përgjithshëm (sipas rregullës fiskale)	***-78***	***-95***	***-97***	***-96***	***-83***
5. BILANCI I PËRGJITHSHËM	**-111**	**-122**	**-300**	**-302**	**-298**
BPV	5,568	6,031	6,410	6,716	7,058
Deficit i përgjithshëm si % e BPV	-1.4%	-1.6%	-1.5%	-1.4%	-1.2%
Bilanci bankar si % e BPV	3.6%	5.5%	5.5%	5.4%	4.8%
Shpenzimet rrjedhëse si % e BPV	20.6%	20.3%	19.9%	19.5%	19.1%

Burimi: Thesari, Buxheti sipas viteve, dhe llogaritjet e Njësisë së Makros

2.3 Përspektiva buxhetore afat mesme

Projeksionet buxhetore afatmesme ndjekin objektivat kryesore të programit të Qeverisë, përmes politikës fiskale, duke siguruar qëndrueshmërinë afatmesme të financave publike dhe në një njëjtën kohë duke siguruar që shpenzimet publike janë të drejtuara në drejtim të shpenzimeve të larta kapitale që mbështetësin rritjen dhe stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik. Sipas këtyre parimeve, korniza afat-mesme buxhetore e paraqitur ka qenë temë e diskutimeve intensive me FMN-në gjatë misionit të kryer në kuadër të programit të Marrëveshjes Stand-by dhe ka dakordim të plotë sa i përket strukturës së shpenzimeve dhe të hyrave të projektuara. Sipas marrëveshjes me FMN-në, korniza buxhetore e paraqitur është miratuar në kohën e duhur në Qeveri dhe pritet ti ndjekë si duhet procedurat e parashikuara të miratimit në Kuvend.

2.3.1 Projektimi afatmesëm i të hyrave 2017-2019

Projeksionet e të hyrave të përgjithshme afatmesme bazohen në zhvillimet e përgjithshme makroekonomike dhe ndikimin e këtyre zhvillimeve në bazën tatimore. Për më tepër, përveç zhvillimeve të përgjithshme ekonomike, projektimi i të hyrave merr parasysh edhe performancën e të hyrave në periudhën e mëparshme afat-mesme. Si të tilla, të hyrat e parashikuara bazohen në

normën mesatare të rritjes reale ekonomike prej 3.9% gjatë periudhës afatmesme. Rritja reale ekonomike e kënaqshme u materializua gjatë vitit 2015 dhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, së bashku me performancën e kënaqshme tatimore gjatë vitit 2015, dhe në veçanti gjatë vitit 2016, bëjnë që parashikimi i të hyrave totale buxhetore për periudhën afatmesme të konsiderohet si i moderuar (konservator). Parashikimi i të hyrave mund të konsiderohet konservatore meqë rritja nominale e BPV-së pritet të rritet me 5.4% (rritja nominale e BPV-së është përcaktuesi kryesor i mbledhjes së taksave), ndërsa norma e rritjes së të hyrave tatimore është më e ulët për 0.4 pikë përqindje.[4] Rrjedhimisht, projeksioni i të hyrave në një qasje optimiste fillimisht do të marrë parasysh shumën e plotë të normës nominale të rritjes së BPV-së si një përcaktues i të hyrave tatimore, si dhe luftën kundër ekonomisë joformale dhe avancimet e efikasitetit në mbledhjen e të hyrave nga agjencitë e mbledhjes. Megjithatë, si rezultat i pasigurisë për materializimin e plotë tëkëtyre të ardhurave, qasja konservatore gjithmonë rekomandohet për të siguruar nivel të menaxhueshëm të shpenzimeve.

Bazuar në këtë planifikim fiskal të kujdesshëm, të hyrat totale të projektuara si pjesë e BPV-së gjatë periudhës afatmesme pritet të arrijnë një mesatare prej 23.6%, që paraqet një rritje prej 0.2 pikë përqindje në krahasim me buxhetin 2016. Më konkretisht, të hyrat janë parashikuar të arrijnë në 1,725 milion euro për vitin 2017, që paraqet një rritje prej 5.6% në krahasim me vitin buxhetin 2016[5]. Të hyrat e përgjithshme buxhetore, në veçanti të hyrat tatimore, pritet të vazhdojnë të dominohen nga të hyrat e mbledhura në kufi, edhe pse ndryshimet e fundit në Ligjin për TVSH-në priten të zhvendosin gradualisht mbledhjen e tatimit në vend. Rritja e parashikuar në të hyrat tatimore pritet të materializohet kryesisht nga taksat indirekte, d.m.th TVSH dhe akcizat, ndërsa një rënie graduale e të hyrave nga tarifat doganore është parashikuar si rezultat i fillimit të zbatimit të marrëveshjeve të MSA-së. Një rritje graduale në të hyrat nga tatimi i drejtpërdrejtë është parashikuar, megjithatë, baza mbetet e ulët.

Edhe pse baza e të hyrave të brendshme mbetet e ulët, performanca e të hyrave të brendshme në vitin 2015 dhe 2016 ka dhënë sinjale pozitive për një rritje të përshpejtuar drejtuar nga rritja e aktivitetit ekonomik dhe mbështetur nga reformat strukturore që janë ndërmarrë. Prandaj, bazuar

[4]Përveç kësaj, të hyrat gjatë vitit 2016 pritet të rriten me rreth 12% në krahasim me të hyrat e realizuara në vitin 2015.
[5]Vlen të përmendet – për periudhën afatmesme - nuk ka masa të hyrave të parapara, me përjashtim të zbatimit të kalendarit akcizës në duhan

në performancën e kaluar dhe arsyeshmërinë ekonomike (të dhënave aktuale), mbledhja e taksave të brendshme pritet të ndjekë nga afër zhvillimet në aktivitetin ekonomik. Prandaj, siç shihet nga grafiku më poshtë (shih grafikun 19), mbledhja e të hyrave të brendshme pritet të ndjekë një ritëm më të përshpejtuar të rritjes afat-mesme, që rezulton nga rritja e pritshme të aktivitetit ekonomik. Megjithatë, sipas qasjes konservatore në projeksionin e të hyrave, pavarësisht normës së pritur të përshpejtuar të rritjes së BPV-së, pjesëmarrja e të hyrave vendore në BPV pritet të rritet gjatë periudhës afatmesme me 0.3 pikë përqindjeje në krahasim me buxhetin 2016.

Grafiku 19. Trendi i të hyrave tatimore për 2006-2019 dhe raporti me treguesit ekonomik



Burimi: Thesari, Buxheti 2016 dhe llogaritjet e Njësisë së Makros në MF

Në vitin 2017, të hyrat vendore parashikohet të arrijnë në € 410 milionë euro dhe parashikohet të arrijë në 470 milion € të në fund të vitit 2019.[6] Projeksionet e të hyrave vendore për vitin 2017 janë më të larta me rreth 9% në krahasim me vitin 2016 dhe me një rritje mesatare 7% në vitet që do të vijnë. Më konkretisht, të hyrat vendore sipas kategorive pritet të materializohen si më poshtë:

- *Tatimi mbi të ardhurat e korporatave*: parashikohen të arrijnë në €84 milion në vitin 2017, që paraqet një rritje prej 13.4% në krahasim me buxhetin 2016 dhe rritjen me një normë mesatare prej 9% në afat të mesëm. Rritja e parashikuar për 2017 rezulton nga rritja e aktivitetit ekonomik gjatë 2015 dhe 2016 dhe për shkak të pritjeve për vitin 2017 dhe si rezultat i fitimeve të larta të deklaruara nga sektori privat, në sektorin financiar veçanërisht.[7]

[6]Shuma e parashikuar nga të hyrat nga tatimet vendore përjashtojnë të ardhurat e gjeneruara nga ATK në emër të Ligjit për falje të borxhit dhe të ardhurat nga borxhet e NSH.
[7] Sipas të dhënave të Bankës Qendrore, sektori bankar ka deklaruar një fitim vjetor prej 94.7 milionë gjatë vitin 2015 dhe 61.3 milionë deri në shtator 2016.

- *TVSHvendore*: parashikohet të arrijë në €184 milionë euro, që paraqet një rritje prej 9.5% në krahasim me vitin buxhetin 2016 dhe rritjen me një normë mesatare prej 5% në afat të mesëm. Rritja e projektuar rezulton nga rritja e përgjithshme në konsum (konsumi është nxitësi kryesor i rritjes), ku TVSH-ja mbetet një tregues i rëndësishëm i konsumit privat. Përveç kësaj, kjo rritje është e bazuar në ndryshimet e taksave në 2015, ku lirimi nga pagesa e TVSH-së në kufi për linjat e prodhimit do të reflektojnë në rritje të deklarimit të TVSH-së brenda vendit në vitet e ardhshme.
- *Tatimi mbi të ardhurat personale*[8], për vitin 2017 janë parashikuar të arrijnë në € 135 milionë euro, që paraqet një rritje prej 8.7% krahasuar me vitin 2016 dhe në rritje me një normë mesatare prej 9% në afat të mesëm. Kjo rritje e parashikuar bazohet në zhvillimet në ecurinë ekonomike dhe efektet e saj në tregun e punës

Për sa i përket të hyrave kufitare, në mungesë të ndryshimeve në normat e taksave, të hyrat kufitare kanë ndjekur historikisht vlerën dhe sasinë e importit.[9] Prandaj, meqë importet janë parashikuar të vazhdojnë rritjen me normë të moderuar, të hyrat kufitare pritet të rriten, megjithëse me një ritëm më të ngadaltë. Ky ngadalësim në rritjen e të hyrave të mbledhura në kufi është për shkak të zbatimit të MSA-së dhe lirimeve të TVSH që rezultojnë nga ndryshimet e politikave tatimore që nga shtatori 2015.

Grafiku 20. Trendi i të hyrave tatimore 2006-2019 dhe raporti me treguesit ekonomik, *(në miliardë euro)*



[8]Ky artikull përfshin tatimin e ndalur në burim, tatimin në të ardhurat individuale të biznesit, si dhe tatimin mbi interesat, dividentët, qiranë dhe lojrat e fatit.
[9] Sasia e importuar përdoruret për të parashikuar mbledhjen e të hyrave nga akcizat.

Burimi: Thesari, Buxheti 2016 dhe llogaritjet e Njësisë së Makros në MF

Në vitin 2017, të hyrat e mbledhura nga doganat janë planifikuar të arrijnë në € 1.108 milion, që paraqet një rritje prej 6.5% në krahasim me buxhetin e vitit 2016 dhe në periudhën afatmesme, të hyrat e mbledhura në kufi janë parashikuar të rriten me një mesatare prej 4.7% . Më konkretisht, të hyrat nga doganat të ndara në kategori pritet të gjenerohen si më poshtë:

- *TVSH në kufi*: si një nga kontribuesit më të mëdha të të hyrave doganore, mbledhja e TVSH në kufi është parashikuar të arrijë në € 564 milionë euro, një rritje prej 9.6% në krahasim me buxhetin 2016 dhe rritje me një normë mesatare prej 5.6% gjatë periudhës afatmesme.
- *Taksa e akcizës:* është parashikuar të arrijë në € 422 milionë në vitin 2017, që paraqet një rritje prej 8% në krahasim me buxhetin 2016 dhe një rritje me 5.8% në periudhën afatmesme. Ky parashikim është i bazuar në rritjen e normës së akcizës të produkteve të duhanit sipas kalendarit të akcizës. Përveç kësaj, rritja e sasisë së naftës së importuar gjatë vitit 2016, si rezultat i rënies stabilizimit të çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare, pritet të vazhdojë dhe të mbështesë më tej kërkesën në rritje për produktet e naftës.
- *Tarifat doganore:* priten të arrijnë në €116 milionë euro, që paraqet një rënie prej 9.8% në krahasim me vitin 2016 dhe një rënie të tejshme në periudhën afatmesme me një mesatare prej rreth 4%. Kjo tendencë në rënie është si rezultat i zbatimit të MSA-së.

Në lidhje me të hyrat jo-tatimore për vitin 2017, një ngadalësim në mbledhjen e të hyrave është parashikuar, duke reflektuar ngadalësimin e mbledhjes së të hyrave në nivel komunal. Në mënyrë të veçantë, gjatë 2017, si rezultat i mbledhjes më të ulët seç ishte planifikuar në vitet e mëparshme, parashikimet e të hyrave vetanake të nivelit lokal janë projektuar të arrijnë në € 54 milionë euro. Për më tepër, të ardhurat nga renta minerare do të është parashikuar të përfaqësojnë 1.9% të totalit të të ardhurave gjatë periudhës së parashikuar. Përveç kësaj, PTK dividend prej 5 milion € dhe € 9 milionë euro nga koncesion tatimor në aeroport "Adem Jashari parashikohet të mblidhen në bazë të të ardhurave jo-tatimore.

Tabela 10: Struktura e të hyrave buxhetore, *si % e BPV*

Përshkrimi	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Totali i të hyrave	24.2	26.4	27.1	26.9	26.7	26.8
Të hyrat tatimore	20.9	22.8	23.4	23.6	23.5	23.7
Të hyrat jo-tatimore dhe THV	3.1	3.4	3.5	3.1	3.1	3.0

Shpenzimet Buxhetore Afatmesme 2017-2019

Projeksionet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2017 dhe projeksionet themelor për vitin 2018 dhe 2019 janë përgatitur bazuar në hapësirën e dhënë nga parashikimet e të hyrave buxhetore dhe niveli i deficitit të detyrueshëm buxhetor (niveli maksimal prej 2% të BPV-së), siç përcaktohet në bazë të rregullës fiskale në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe obligimet që dalin nga Marrëveshja Stand-by me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Kjo shërben si një garanci e disiplinës buxhetore, e cila mundëson ruajtjen e stabilitetit makro-fiskal në fazën e planifikimit. Megjithatë, në kuadër të këtij buxheti, ruajtja e stabilitetit makro-fiskal nuk është një qëllim në vetvete, por një parakusht për arritjen e qëllimit përfundimtar të mbështetur zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit

Duke pasur parasysh këtë, buxheti i propozuar është projektuar në katër komponente kryesore:

(1) Ruajtja e nivelit të shpenzimeve aktuale – duke siguruar kështu një financim adekuat për ofrimin e shërbimeve publike dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe të mirëqenies së qytetarëve;
(2) Rritja e financimit për projektet kapitale, të financuara nga të hyrat e rregullta buxhetore;
(3) Përdorimi i hapësirës së krijuar për projektet kapitale strategjike për zhvillimin përmes klauzolës së investimit;
(4) Përdorimi i fondeve nga likuidimi i NSH-ve dhe krijimi i një lidhje për të drejtuar fondet për projekte specifike kapitale.

Bazuar në këto shtylla e buxhetit, shpenzimet për vitin 2016 janë planifikuar të arrijnë në rreth 2 miliard euro, shuma më e lartë që nga themelimi i institucioneve të Republikës së Kosovës. Pavarësisht rritjes së mprehtë në totalin e shpenzimeve në krahasim me shpenzimet e kryera në vitin 2015 dhe 2016, si rezultat i një performance të mirë fiskale gjatë dy viteve të fundit, deficiti i përgjithshëm i buxhetit është planifikuar të mbahet nën tavanet e përcaktuara në rregullën fiskale. Duke pasur këtë parasysh, shpenzimet totale buxhetore për vitin 2017 janë planifikuar të jenë rreth 15.6% më të larta se në vitin 2016 dhe 29% më të larta se shpenzimet e realizuara në vitin 2015.

Kjo rritje e konsiderueshme në shpenzimet e përgjithshme, e nxitur nga rritje e konsiderueshme në shpenzimet kapitale, ndjek parimet e përcaktuara në Programin e Qeverisë të cilat kërkojnë një prioritizim të qartë të shpenzimeve që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, pa dëmtuar përmirësimin e mirëqenies sociale dhe akomodojnë nevojat e agjendës së integrimit të Kosovës. Si rezultat i këtyre shpenzimeve shtesë të mundësuara nga rritja e të ardhurave të rregullta të buxhetit dhe krijimi i hapësirave të reja për financimin e shpenzimeve kapitale zhvillimore, struktura e shpenzimeve totale të buxhetit është zhvendosur drejt shpenzimeve kapitale, pas pengesave gjatë periudhës së mëparshme.

2.3.2 Shpenzimet e buxhetit sipas kategorive ekonomike

Tabela e mëposhtme zbërthen shpenzimet e qeverisë sipas kategorive ekonomike. Ajo mbulon shpenzimet aktuale për vitin 2015, shpenzimet e buxhetuara dhe rishikuara për vitin 2016, si dhe shpenzimet e parashikuara për vitin 2017, 2018 dhe 2019. Siç mund të konkludohet nga tabela, shpenzimet qeveritare në vitin 2017 parashikohet të jenë rreth 16% më të larta se në vitin 2016. Në krahasim me shpenzimet buxhetore aktuale nga 2015, shpenzimet e parashikuara për vitin 2017 nënkuptojnë një rritje prej gati 28% e ndjekur nga rritja graduale që shkojnë në drejtim të 2019, duke arritur edhe në mbi 2 miliardë euro.

Është e rëndësishme të theksohet se ky shpenzim buron kryesisht nga realizimi i projekteve kapitale me financim të huaj (d.m.th klauzola e investimeve, si dhe përdorimi i pranimeve nga likuidimi i AKP). Rritja e shpenzimeve produktive dhe përmbajtja e shpenzimeve jo-produktive është një nga objektivat kryesore të Qeverisë së Kosovës, në përpjekje për të mbajtur financat publike të qëndrueshme të cilat mund të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik.

Tabela 11. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike, në milionë euro

Përshkrimi	2015	2016	2017	2018	2019
në milionë euro					
TOTALI I SHPENZIMEVE	**1,564**	**1,732**	**2,001**	**2,064**	**2,160**
SHPENZIMET RRJEDHËSE	**1,149**	**1,221**	**1,275**	**1,310**	**1,348**
Pagat dhe mëditjet	525	549	572	597	622
Mallrat dhe Shërbimet	205	207	225	228	232
Subvencionet dhe Transferet	418	466	473	479	492
SHPENZIMET KAPITALE	**404**	**500**	**722**	**753**	**810**

Burimi: Thesari, MF

Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike pritet të mbetet relativisht e ngjashme me ato të viteve të kaluara, përveç për një rritje të shpenzimeve kapitale. Grafiku i mëposhtëm vizualizon shumën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për buxhetit (e rishikuar) për 2016 dhe buxhetin e parashikuar për vitin 2017. Grafiku sugjeron se shpenzimet e përgjithshme të qeverisë në dy periudha të dominohet nga shpenzimet rrjedhëse, që përbën rreth 70% në vitin 2016 dhe bie në rreth 63.7% në buxhetin e planifikuar për vitin 2017.

Në mënyrë të ngjashme, shpenzimet rrjedhëse përfaqësojnë më shumë se 20% të BPV-së në vitin 2016 dhe pritet të bjerë nën këtë nivel gjatë 2017-2019. Shpenzimet kapitale përbëjnë rreth 29% të shpenzimeve totale të qeverisë në vitin 2016. Megjithatë, një rritje të konsiderueshme në pjesën e shpenzimeve kapitale është planifikuar në vitin e ardhshëm duke rezultuar në rritje të kësaj pjese me 36%. Në kushtet e pjesëmarrjes në BPV, kjo nënkupton një zhvendosje nga 8.3% në rishikimin e buxhetit të vitit 2016 për një pjesë 11.3% të BPV-së në buxhetin e projektuar për vitin 2017.

Pagat dhe mëditjet përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve në vitin 2016. Siç tregon edhe grafiku, pagat dhe mëditjet janë planifikuar të rriten nga 549 milionë euro në vitin 2016 në rreth 572 milion euro në vitin 2017, një rritje prej 4.3% në mes të dy periudhave. Subvencionet dhe transferet pritet të arrijën në 473 milionë euro në vitin 2017, një nivel i ngjashëm me atë të vitit të kaluar. Kjo kategori e shpenzimeve, e cila përfshin transferet sociale dhe subvencione për NP-ve, pritet të arrijë në 27% të shpenzimeve totale në vitin 2017.

Grafiku 21. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive, në milionë euro



Burimi: Thesari, MF

Mallrat dhe shërbimet pritet të rritet nga rreth 207 milionë euro në buxhetin e rishikuar për vitin 2016 në 225 milionë euro t projektuara për vitin 2017. Kjo do të thotë një rritje prej 8.6% të shpenzimeve për mallra dhe shërbime mes 2016 dhe 2017. Pavarësisht nga rritja në terma absolute, në raport me totalin e shpenzimeve, pjesa e pritur nga kjo kategori zvogëlohet gradualisht duke shkuar drejt së ardhmes. Është për t'u theksuar se qeveria është duke kaluar nëpër reforma të rëndësishme në lidhje me përmirësimin e efikasitetit të shpenzimeve publike, duke zbatuar teknikat më të avancuara të prokurimit (si prokurimi elektronik, i cili do të të përfshijë gradualisht të gjitha nivelet e qeverisjes në vend).

Shpenzimet kapitale në vitin 2017 pritet të arrijnë në 722 milionë euro. Kjo shumë përfaqëson 36% të shpenzimeve të projektuara të qeverisë për vitin 2017 dhe rreth 11% të BPV-së të të njëjtit vit. Disa nga projektet kapitale që janë të përfshira në buxhetin përfshijnë autostradën Prishtinë-Shkup, në rrugën M2 në Mitrovicë, dhe rrugën M9 në Pejë. Buxheti i parashikuar gjithashtu parashikon projekte të infrastrukturës për fusha të tjera me interes, si arsimi dhe sporti.

2.4 Potencialet zhvillimore dhe rreziqet fiskale për periudhën 2017-2019

Në vazhdimësi të vlerësimeve paraprake për KASH 2016-2018, edhe në periudhën afatmesme 2017-2019 skenari bazë makro-fiskal përcjellët me potenciale zhvillimore që mund të çojnë drejt një rritjeje më të lartë ekonomike dhe drejt një hapësire më të gjerë fiskale. Në të njëjtën kohë, ky skenar po ashtu përcjellët me rreziqe fiskale që kanë të bëjnë me pengesa të trashëguara në strukturën e ekonomisë Kosovare. Në krahasim me KASH-in paraprak, vlerësohet se nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme në burimin e rreziqeve fiskale. Në të njëjtën kohë, gjasat e realizimit të potencialeve zhvillimore janë ngritur.

Një vlerësim i kuantifikuar i potencialeve zhvillimore dhe rreziqeve fiskale për periudhën afatmesme përmes skenarëve alternativ është paraqitur në Janar të këtij viti si pjesë Programit për Reforma në Ekonomi.

2.4.1 Potencialet zhvillimore

Adresimi i Hendekut Infrastrukturor përmes Klauzolës për Investime – Pas amandamentimit të Ligjit për Financat Publike dhe Përgjegjësitë, gjegjësisht Nenit 22A të këtij Ligji, Qeveria e Kosovës ka krijuar mundësinë e shfrytëzimit të mundësive të favorshme për investim nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare për të adresuar nevojat e larta të modernizimit të infrastrukturës publike. Përmes kësaj mase, pritet që përgjatë periudhës afatmesme të gjenerohen investime shtesë ne vlerë mesatare prej 1.5% të BPV-së.

Dy Projekte të Mëdha Zhvillimore: Zhvillimi i Kapaciteteve të Reja për Prodhim të Energjisë dhe Zhvillimi i Resorit Turistik të Brezovicës - Përveç adresimit të një prej rreziqeve më eminente strukturore të ekonomisë Kosovare, gjegjësisht furnizimit të sigurt me energji elektrike, ndërtimi i kapaciteteve të reja për zhvillim të energjisë mund të ngrejë nivelin e investimeve agregate në ekonomi. Me një vlerë totale prej rreth 20%-25% të mesatares vjetore të BPV-së përgjatë 2017-2019, ndikimi i këtij në skenarin makro-fiskal do varet nga shpërndarja e investimit nëpër vite. Një shpërndarje e barabartë brenda pesë viteve e vlerës së përgjithshme të investimit pritet të çojë në një përshpejtim të rritjes ekonomike prej së paku një pikë përqindjeje të BPV-së, në terma real. Në të njëjtën kohë, edhe projekti i zhvillimit të resorit turistik të Brezovizës pritet të ketë efekt të ngjashëm, afatmesëm dhe afatgjatë. Efekti afatmesëm pritet të përshpejtojë rritjen e investimeve me së paku 3.5% në terma real.

Efektet Ekonomike të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocijim (MSA) – Qëllimi përfundimtar i kësaj marrëveshje është forcimi i themeleve të një ekonomike funksionale tregu, dhe si e tillë marrëveshja pritet të ketë efekte shumëfishuese në ekonomi. Në skenarin makro-fiskal për periudhën afatmesme 2017-2019 është marrë për bazë efekti i humbjeve nga provizionet e tregtisë së lirë, gjegjësisht nga heqja apo reduktimi i taksës doganore për produkte me origjinë nga Bashkimi Evropian. Këto humbje në të hyra buxhetore janë përllogaritur me një mesatare prej rreth 25 milionë euro në vit. Por, në të njëjtën kohë, si pjesë e skenarit makro-fiskal nuk janë përllogaritur efektet e transferimit të kësaj vlere në të hyrat e disponueshme të sektorit privat. Si rrjedhojë, efektet ekonomike të MSA-së kanë potencial për të prodhuar rritje më të lartë ekonomike se sa parashikimet e skenarit bazë marko-fiskal.

Efektet nga hyrja në fuqi e Ligjit për Investimet Strategjike - Qeveria e Republikës se Kosovës në gusht të vitit 2015 aprovoi Koncept dokumentin për Investime Strategjike në Republikën e Kosovës, qëllimet e të cilit janë në pajtim edhe me objektivat e Programit Qeverisës.

Projektligji në vetvete parasheh kritere si vlera e përgjithshme e investimeve, hapja e vendeve të reja të punës, ofrimi i teknologjive të reja për të rritur konkurrueshmërinë dhe efektivitetin e investimeve, si dhe rritja e nivelit dhe cilësisë së jetës së qytetarëve dhe mbrojtja e mjedisit dhe konsumatorit. Vlen të theksohet se sipas këtyre kritereve dhe me themelimin e Komisionit për Negocimin e Marrëveshjeve për Investime Strategjike, Qeveria mund t'i jep të drejtën e shfrytëzimit të pronës shtetërore të Republikës së Kosovës tek investitorët e huaj pa pasur nevoje për hapjen e procedurave tenderuese.

Përmes kësaj iniciative pritet që të eliminohen barrierat potenciale në thithjen dhe realizmin e investimeve të huaja siç janë burokracia e tepërt, mungesa e transparencës, infrastruktura ligjore jo e favorshme. Kështu, kjo nismë përcakton procedurat dhe rregullat favorizuese, lehtësuese dhe përshpejtuese për sektorët që vlerësohet të jenë me ndikim në rritjen ekonomike dhe punësimin.

2.4.2 Rreziqet fiskale

2.4.3 Rreziku sistematik (makroekonomik)

Varësia nga Remitencat: Si karakteristikë strukturore e ekonomisë Kosovare, ndikimi i modelit të rritjes ekonomike vazhdon të ndikohet lartë nga rrjedha e remitencave. Përderisa remitencat ofrojnë një burim të rëndësishëm të konsumit dhe investimeve të ekonomive shtëpiake, rrjedha e tyre ndikohet nga faktorë të jashtëm, gjegjësisht nga ndryshimet në ekonomitë në të cilat është e përqendruar diaspora Kosovare. Tronditjet në këto ekonomi mund të përcjellën edhe në ekonominë Kosovare, dhe të kenë efekt negativ edhe në hapësirën fiskale mbi të cilën ndërtohet ky KASH.

Diversifikimi i Ulët i Eksporteve – Metalet bazike dhe artikujt e metaleve bazike, si dhe produktet minerale përbëjnë mbi 50% të vëllimit dhe mbi 40% të vlerës së eksporteve të mallrave në Kosovë. Si rrjedhojë, eksportet e mallrave janë shumë të ekspozuara nga ndikimi i çmimeve të metaleve

dhe kërkesa e jashtme për produkte të tilla. Kjo bën që diversifikimi i ulët i eksporteve të identifikohet si rrezik permanent i skenarit bazë marko-fiskal.

Kapacitetet e Vjetërsuara për Prodhim të Energjisë – janë po ashtu burim i rrezikut ndaj parashikimeve të skenarit marko-fiskal të paraqitur me KASH 2017-2019. Tronditjet e mundshme në prodhimin e energjisë shkaktojnë rritje të kostos së energjisë dhe kanë ndikim si në konsumin e energjisë ashtu edhe në ofertën e sektorëve tjerë ekonomik, por që mund të përcjellët edhe me presionet për asistencë buxhetore për këtë sektor. Ky rrezik që ndërlidhet me problemet e trashëguara strukturore të ekonomisë Kosovare pritet të adresohet përmes ndërtimit të kapaciteteve të reja energjetike.

2.4.4 Rreziqet specifike (nga politikat)

Ngushtimi i Hendekut Tatimor – ashtu si në periudhat paraprake, parashikimet e të hyrave bazohen jo vetëm në rritjen e të hyrave si rezultat i zhvillimeve makroekonomike, por edhe në ngushtimin e hendekut tatimor. Prandaj, hapësira e parashikuar fiskale mbi të cilën bazohet ky KASH është e varur edhe nga suksesi i politikave administrative dhe stimuluese për ngushtimin e hendekut tatimor.

Tejkalimi i Kostove të Parapara të Politikave– Kualiteti i kostimit të politikave të parapara si pjesë e procesit buxhetor është element vital në saktësinë e përpilimit të vlerësimeve për KASH 2017-2019. Duke lënë mënjanë vështirësitë teknike të kostimit të politikave, cilitdo rast nën-vlerësimi i kostove të politikave publike nga ana e Organizatave Buxhetore mund të jetë burim i rrezikut fiskal për periudhën afat-mesme.

2.4.4.1 Rreziqet fiskale jashtë-buxhetore

Duke qenë se Qeveria e Kosovës nuk ka fonde jashtë-buxhetore, si p.sh. fonde jashtë-buxhetore të sigurimit social, apo banka në pronësi publike, rreziku jashtë buxhetor në rastin e Republikës së Kosovës është tejet i limituar. Nga perspektiva e Qeverisjes Qendrore, janë dy burime të rrezikut jashtë-buxhetor që adresohen si pjesë e analizës së rrezikut për KASH.

Rreziqet e Ndërlidhura me Pronësinë e Ndërmarrjeve Publike - Qeveria e Republikës së Kosovës ka në pronësi 18 Ndërmarrje Publike. Sipas të dhënave financiare preliminare (të pa-audituara), në vitin 2015 vlera kontabël e tyre është gjithsej € 638,77 milion, apo rreth 2.80% më pak se në vitin paraprak. Në të njëjtën kohë, vlera kontabël e detyrimeve në vitin 2015 është € 615.90 milion, apo 4.34% më të shumë se në vitin paraprak.

Gjatë vitit 2015, Ndërmarrjet Publike Qendrore janë karakterizuar me një rritje të të hyrave të shitjes për 2.93%, ndërsa kontributet e jashtme në vitin 2015 që kapin një vlerë prej 8.9 mil. euro kanë shënuar rënies prej 12.12% në krahasim me vitin paraprak. Gjithashtu, detyrimet afatgjata tregojnë një rritje prej 8.04% që reflekton rritje të financimeve afatgjata përmes borxhit të garantuar nga qeveria.

Përkundër rritjes të hyrave nga shitjet, pasuritë e ndërmarrjeve publike kanë shënuar rënie për -1.05%, që reflekton rritjen e shpenzimeve të stafit dhe uljen e financimeve nga jashtë në formë të granteve, si nga aksionari ashtu edhe nga partnerët zhvillimor.

Si rrjedhojë, përgjatë periudhës afatmesme, përqendrim i mëtejshëm në vetë-qëndrueshmërinë financiare dhe operative të korporatave në pronësi publike është i nevojshëm për të mbajtur në kontroll rreziqet eventuale nga tkurrja e pasurive të korporatave, që mund të rrezikoj aktivizimin e garancive të dhëna nga Qeveria Qëndrore.

Po ashtu, brenda periudhës afat-mesme, Ndërmarrjet Publike duhet të kenë kujdes të shtuar në shpalosjen e situatave të jashtme për të evituar humbje të likuiditetit dhe aftësisë për mbulimin e shpenzimeve operative. Nga perspektiva e Qeverisë Qëndrore, kjo do mund të paraqitej si rrezik nga kërkesa të shtuara për grante/subvencione.

III. Korniza e Shpenzimeve Sektoriale- Qeveria Qëndrore

- Korniza e Shpenzimeve Sektoriale synon specifikim e shpenzimeve sipas sektoreve ne vijim:

- *Sektori i Qeverisjes së përgjithshme,*
- *Sektori për Bashkpunim Ndërkombtarë,*
- *Sektori i Financave Publike,*
- *Sektori i Mbrojtjes dhe Sigurisë Publike,*
- *Sektori i Drejtësisë,*
- *Sketori i Infrastrukturës dhe Konkurrencës,*
- *Sektori i Bujqësisë,*
- *Sektori i Mjedisit,*
- *Sektori i Kulturës,*
- *Sektori i Arsimit,*
- *Sektori i Shëndetësise,*
- *Sektori për Çështje Sociale.*

IV. Niveli Komunal

4.1 Financimi Komunal

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2017-19 për nivelin komunal ofron udhëzimet për komunat për përgatitjet e buxhetit për 2017 dhe orientimet për 2018 dhe 2019, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, ky dokument përcakton shumat agregate të granteve qeveritare për financimin e komunave dhe nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2017 si dhe parashikimin afatmesëm 2018-2019.

Parimet, kriteret dhe formulat të zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2017 bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale të përgatitur nga Ministria e Financave siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale si dhe,
- Prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin e tanishëm buxhetor dhe për dy vitet pasuese.

Buxhetimi i projekteve kapitale shumëvjeçare përfshinë integrimin e të dhënave të planifikuara nga komunat në sistemin e Projekteve të Investimeve publike (PIP) dhe buxhetimin në bazë të performancës. Si rrjedhojë, nga komunat kërkohet të hartojnë strategjinë kornizë bazuar në synimet dhe objektivat të orientuara në rezultate.

4.2 Burimet e Financimit Komunal për vitin 2017-2019

Burimet e financimit Komunal janë:

- Granti i përgjithshëm;
- Granti i Arsimit;
- Granti i Shëndetësisë;
- Financimet tjera (shërbimet sociale, rezidenciale, shëndetësia sekondare);
- Të hyrat vetanake të Komunave.

Pjesmarrja e buxhetit komunal në buxhetin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës për vitin

2017përafësisht është nga 26 % deri në 27%, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake komunale.

Grafiku 22: Pjesëmarrja e financimit komunal në buxhetin e përgjithshëm 2014-2019



4.2.1 Granti i Përgjithshëm për vitin 2017 dhe parashikimet 2018-2019

Bazuar në Tabelën 1, të përgatitur nga Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Fiskale të Ministrisë së Financave në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2017 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 149,200,000 euro.Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL, ku 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore iu ndahen komunave, duke përjashtuar të hyrat vetanake të nivelit qendror, mbështetjen buxhetore dhe grantet, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga dividenta, grantet e përcaktuara të donatorëve si dhe taksat dhe ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale.

Siç paraqitet në tabelën në vijim, bazuar në vlerësimet e Departamentit të Politikave Ekonomike dhe Fiskale, të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2017 pritet të jenë 1,644 milion euro. Nga kjo shumë, zbriten ato të hyra siç specifikohet në nenin 24 të LFPL dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, i cili grant për vitin 2017 është në shumë prej 149.2 milion euro.

Tabela 13: Përcaktimi i shumës së Grantit të Përgjithshëm për komuna për 2017-19

	2014	2015	2016	2017	2018	2019
A. Të hyrat e përgjithshme të Qeverisë	**1,392**	**1,571.8**	**1,588**	**1,644.0**	**1,701.0**	**1,779.0**
Zbriten:						
Të hyrat vetanake të niveli Qendror	(40)	(40)		(45.0)	(46.0)	(47.0)
Mbeshtetja buxhetore dhe grante			(20.8)	(1.0)	-	-
Tatimi në pronë				(25.0)	(25.0)	(26.0)
Të hyrat nga dividend			(30)	(15.0)	(15.0)	(15.0)
Grantet e pergaktuara të donatorve			(12.1)	(12.0)	(12.0)	(12.0)
Taksa ngarkesa dhe të tjera nga Qeveria Lokale	(74)	(74.2)	(121)	(54.0)	(54.0)	(54.0)
Të hyrat e njehershme			(55)			
B. Baza për llogaritjen e grantit të përgjithshëm për komuna	**1,278**	**1,457.6**	**1,349.1**	**1,492.0**	**1,549.0**	**1,625.0**
C. Granti i përgjithshëm për komuna (10% e B)	**127.8**	**145.7**	**134.9**	**149.2**	**154.9**	**162.5**

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse (paushalle) prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy përqind (2%); (v) dhe gjithashtu është paraparë një kontigjencë për korrektim të formulës për shpërndarjen e pjesës së grantit të përgjithshëm për komuna në vlerë prej 4 milion euro.

Tabela 16: Granti i Përgjithshëm sipas viteve 2014-2019, sipas komunave,

Nr	Komuna	Granti i përgjithshëm 2014	Granti i përgjithshëm 2015	Granti i përgjithshëm 2016	Granti i përgjithshëm 2017	Granti i përgjithshëm 2018	Granti i përgjithshëm 2019
1	Deçan	2,806,480	3,197,970	2,961,462	3,185,763	3,397,202	3,562,866
2	Dragash	2,978,536	3,394,042	3,143,027	3,381,087	3,605,497	3,781,324
3	Ferizaj	7,154,599	8,184,958	7,562,497	8,152,831	8,709,317	9,145,326
4	Fushë Kosovë	2,479,705	2,823,176	2,615,678	2,812,467	2,997,972	3,143,317
5	Gjakovë	6,547,428	7,487,928	6,919,753	7,458,603	7,966,556	8,364,541
6	Gjilan	5,994,313	6,854,173	6,334,714	6,827,362	7,291,763	7,655,624
7	Gllogoc	3,905,388	4,458,511	4,124,358	4,441,264	4,740,000	4,974,061
8	Hani i Elezit	772,611	865,478	809,375	862,582	912,738	952,035
9	Istog	2,956,691	3,369,804	3,120,234	3,356,923	3,580,040	3,754,854
10	Junik	562,350	624,322	586,883	622,390	655,860	682,084
11	Kaçanik	2,326,160	2,647,217	2,453,260	2,637,206	2,810,605	2,946,465
12	Kamenicë	2,698,336	3,073,614	2,846,901	3,061,912	3,264,596	3,423,400
13	Klinë	2,745,472	3,127,917	2,896,874	3,115,993	3,322,547	3,484,383
14	Leposaviq	1,912,310	2,170,664	2,014,587	2,162,608	2,302,142	2,411,468
15	Lipjan	3,996,898	4,563,123	4,221,055	4,545,468	4,851,281	5,090,886
16	Malishevë	3,686,895	4,207,847	3,893,129	4,191,603	4,472,963	4,693,411
17	Mamusha	731,792	818,191	765,996	815,497	862,159	898,720
18	Mitrovicë	4,834,475	5,523,924	5,107,414	5,502,427	5,874,791	6,166,539
19	Novo Bërdë	801,004	897,591	839,241	894,579	946,744	987,616
20	Obiliq	1,585,143	1,797,298	1,669,131	1,790,683	1,905,265	1,995,041
21	Pejë	6,731,174	7,698,527	7,114,130	7,668,364	8,190,821	8,600,168
22	Podujevë	6,007,698	6,869,251	6,348,769	6,842,387	7,307,703	7,672,280
23	Prishtinë	12,842,237	14,699,843	13,577,625	14,641,922	15,645,195	16,431,264
24	Prizren	12,542,550	14,356,806	13,260,777	14,300,237	15,280,097	16,047,823
25	Rahovec	3,795,892	4,332,840	4,008,459	4,316,098	4,606,098	4,833,315
26	Shtërpcë	843,836	946,649	884,537	943,443	998,972	1,042,479
27	Shtime	1,930,206	2,193,109	2,034,284	2,184,912	2,326,902	2,438,153
28	Skenderaj	3,505,927	4,000,159	3,701,584	3,984,749	4,251,678	4,460,818
29	Suharekë	4,054,544	4,629,414	4,282,123	4,611,489	4,921,970	5,165,234
30	Viti	3,203,519	3,653,448	3,381,636	3,639,419	3,882,420	4,072,813
31	Vushtrri	4,676,741	5,343,079	4,940,531	5,322,302	5,682,184	5,964,153
32	Zubin Potok	1,070,987	1,206,609	1,124,677	1,202,381	1,275,629	1,333,019
33	Zveçan	993,851	1,118,441	1,043,173	1,114,556	1,181,846	1,234,567
34	Gracanicë	1,427,095	1,614,815	1,501,409	1,608,961	1,710,347	1,789,783
35	Kllokot	353,023	384,206	365,368	383,234	400,075	413,271
36	Mitrovica e Veriut	1,419,668	1,606,553	1,493,652	1,600,726	1,701,660	1,780,743
37	Partesh	340,587	369,860	352,175	368,947	384,757	397,144
38	Ranillug	583,880	648,646	609,520	646,626	681,606	709,012
	TOTAL	127,800,000	145,760,000	134,910,000	145,200,000	154,900,000	162,500,000
Ndikimi negativ		9,769,041					
Kontigjenca për korrektim të formulës (për shpërndarje sipas komunave)					4,000,000.00		
	TOTAL	137,569,041	145,760,000	134,910,000	149,200,000	154,900,000	162,500,000

4.2.2 Granti specifik për Arsim parauniversitar për vitin 2017

Granti Specifik për Arsim sipas LFPL bazohet në qasjen me sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret dhe parametrat në formulën shtetërore të arsimit parauniversitar të propozuar nga MASHT për vitin 2017. Formula shtetërore e arsimit parauniversitar trajton në veçanti nivelin e shkollave parafillore, fillore dhe të mesme, duke marrë parasysh këto elemente:

a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2015/2016;
b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3;
c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II
h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin para fillor dhe fillor (bazuar në Udhëzimin administrativ nr.18/2009 të MASHT);
i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm (gjimnazet dhe shkollat profesionale bazuar sipas Udhëzimin administrativ nr.18/2009 të MASHT);
j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollre (roje) bazuar në Udhëzimin administrativ nr.18/2009 të MASHT;
k) Shërbimi profesional 80 pedagogë;
l) Pagat janë kalkuluar duke u bazuar në pagën mesatare sipas niveleve për të gjitha komunat;
m) Përvoja e punës është kalkuluar duke marrë mesataren prej 15 vite;
n) Kalkulimi për stafin mësimdhënës në lehoni është paraparë 3% (bazë stafi mësimdhënës).

Granti specifik për arsim parauniversitar për vitin 2017 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 163.4 milion euro. Duke qenë se në vitin e ardhshëm shkollor, sipas MASHT, pritet të ketë mbi 10,000 nxënës më pak në arsim parauniversitar, atëherë kjo nënkupton se financimi për kokë nxënësi është rritur krahasuar me vitin 2016.

Tabela 18: Granti për arsim parauniversitar sipas viteve 2014-2019

Nr	Komuna	Granti specifik për Arsim parauniversitar 2014	Granti specifik për Arsim parauniversitar 2015	Granti specifik për Arsim parauniversitar 2016	Granti specifik për Arsim parauniversitar 2017	Granti specifik për Arsim parauniversitar 2018	Granti specifik për Arsim parauniversitar 2019
1	Deçan	2,313,411	2,532,862	2,495,467	2,529,924	2,529,924	2,529,924
2	Dragash	2,280,777	2,479,163	2,549,780	2,576,163	2,576,163	2,576,163
3	Ferizaj	9,890,922	10,291,270	10,865,188	11,005,674	11,005,674	11,005,674
4	Fushë Kosovë	2,355,600	2,541,911	2,789,527	2,829,851	2,829,851	2,829,851
5	Gjakovë	6,939,073	7,519,168	7,710,341	7,813,157	7,813,157	7,813,157
6	Gjilan	8,355,944	8,993,563	8,887,908	8,997,593	8,997,593	8,997,593
7	Gllogoc	4,731,775	5,075,390	5,702,442	5,776,357	5,776,357	5,776,357
8	Hani i Elezit	651,052	707,793	754,706	765,257	765,257	765,257
9	Istog	3,018,575	3,265,161	3,575,478	3,620,534	3,620,534	3,620,534
10	Junik	387,085	425,613	349,151	353,865	353,865	353,865
11	Kaçanik	2,519,927	2,725,571	2,678,565	2,713,634	2,713,634	2,713,634
12	Kamenicë	2,528,669	2,818,347	2,591,842	2,625,630	2,625,630	2,625,630
13	Klinë	3,205,167	3,450,535	3,498,851	3,545,627	3,545,627	3,545,627
14	Leposaviq	749,444	863,682	1,054,495	1,066,778	1,066,778	1,066,778
15	Lipjan	4,743,854	5,131,839	5,710,828	5,784,564	5,784,564	5,784,564
16	Malishevë	5,681,675	5,613,973	6,143,164	6,225,524	6,225,524	6,225,524
17	Mamusha	355,950	390,308	511,948	517,306	517,306	517,306
18	Mitrovicë	5,887,212	6,391,756	6,873,181	6,964,598	6,964,598	6,964,598
19	Novo Bërdë	667,211	751,022	785,141	792,213	792,213	792,213
20	Obiliq	1,769,674	1,927,686	2,147,932	2,175,345	2,175,345	2,175,345
21	Pejë	7,177,038	7,751,833	7,870,608	7,978,556	7,978,556	7,978,556
22	Podujevë	7,228,792	7,747,268	8,295,647	8,402,781	8,402,781	8,402,781
23	Prishtinë	14,902,874	15,549,182	17,603,615	17,848,335	17,848,335	17,848,335
24	Prizren	12,675,888	12,535,636	13,632,521	13,810,938	13,810,938	13,810,938
25	Rahovec	4,372,573	4,677,920	4,866,855	4,930,086	4,930,086	4,930,086
26	Shtërpcë	915,529	1,042,501	1,214,703	1,229,384	1,229,384	1,229,384
27	Shtime	2,415,886	2,587,021	2,734,449	2,769,058	2,769,058	2,769,058
28	Skenderaj	4,931,416	5,007,250	5,255,414	5,320,013	5,320,013	5,320,013
29	Suharekë	5,056,738	5,402,712	5,686,790	5,758,277	5,758,277	5,758,277
30	Viti	3,862,532	4,161,278	4,055,934	4,109,477	4,109,477	4,109,477
31	Vushtrri	5,544,311	5,955,076	6,291,206	6,372,875	6,372,875	6,372,875
32	Zubin Potok	375,659	456,056	522,810	529,486	529,486	529,486
33	Zveçan	320,933	377,320	452,177	458,224	458,224	458,224
34	Gracanicë	1,372,599	1,514,117	1,821,933	1,841,452	1,841,452	1,841,452
35	Kllokot	232,841	263,310	304,899	308,294	308,294	308,294
36	Mitrovica e Veriut	1,436,764	1,620,631	2,081,721	2,108,104	2,108,104	2,108,104
37	Partesh	315,328	350,903	360,694	365,940	365,940	365,940
38	Ranillug	388,629	435,385	604,102	611,140	611,140	611,140
TOTAL		142,559,329	151,332,014	161,332,014	163,432,014	163,432,014	163,432,014

Tabela 19: Numri i nxënësve sipas viteve 2009-2017

4.2.3 Granti specifik për Shëndetësi primare për vitin 2017

Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2017 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 44,085,037 euro, ku krahasuar me vitin 2016 ka një rritje prej 2 milion euro. Nga Ministria e Shëndetësisë janë transferuar 5 punëtorë dhe pagat total prej 27,645 euro në dy komuna si vijon: (komuna e Junikut, 3 punëtorë dhe pagat 16,587 euro) dhe (komuna e Parteshit, 2 punëtorë dhe pagat 11,058 euro). Nga kjo rezulton se granti i shëndetësisë rritet edhe për shumën e pagave të transferuara nga MSH prej 27,645 euro, që në total reflekton 44,112,682 euro.

Shpërndarja e grantit specifik për Shëndetësi bazohet në sistem të hapur në përputhje me LFPL.Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2017 është përgatitur në harmoni me prioritet e qeverisë, projeksionet në KASH dhe propozimit nga MSH, si dhe në pajtim me rekomandimet e Komisionit të Granteve të dala nga raporti vjetor mbi Vlerësimin e Përshtatshmërisë së Sistemit të Financimit Komunal për vitin 2015 të aprovuar në Qeveri me datë 30 mars 2016, ku si kriter bazë është marrë numri i popullsisë sipas komunave.

Tabela 20: Granti specifik për Shëndetësi primare në vitet 2014-2019

Nr.	Komuna	Popullsia	Total 2014 (bazuar në vizita dhe shërbime)	Total 2015 (bazuar në vizita dhe shërbime)	Total 2016(bazuar në vizita dhe shërbime)	Total 2017 (bazuar në numrin e popullsisë)	Total 2018 (bazuar në numrin e popullsisë)	Total 2019 (bazuar në numrin e popullsisë)
1	Deçan	40,019	885,597	946,169	946,169	991,134	991,134	991,134
2	Dragash	33,997	752,333	803,791	803,791	841,990	841,990	841,990
3	Ferizaj	108,610	2,403,475	2,567,866	2,567,866	2,689,899	2,689,899	2,689,899
4	Fushë Kosovë	34,827	770,701	823,415	823,415	862,546	862,546	862,546
5	Gjakovë	94,556	2,092,468	2,235,588	2,235,588	2,341,829	2,341,829	2,341,829
6	Gjilan	90,178	1,995,585	2,132,078	2,132,078	2,233,401	2,233,401	2,233,401
7	Gllogovc	58,531	1,295,256	1,383,848	1,383,848	1,449,613	1,449,613	1,449,613
8	Hani i Elezit	9,403	208,083	222,315	222,315	232,880	232,880	232,880
9	Istog	39,289	869,442	928,910	928,910	973,054	973,054	973,054
10	Junik	6,084	134,635	143,844	143,844	167,267	167,267	167,267
11	Kaçanik	33,409	739,321	789,889	789,889	827,427	827,427	827,427
12	Kamenicë	36,085	798,540	853,158	853,158	893,702	893,702	893,702
13	Klinë	38,496	851,894	910,161	910,161	953,414	953,414	953,414
14	Leposavic	13,773	304,788	325,635	325,635	341,110	341,110	341,110
15	Lipjan	57,605	1,274,764	1,361,955	1,361,955	1,426,679	1,426,679	1,426,679
16	Malishevë	54,613	1,208,553	1,291,215	1,291,215	1,352,577	1,352,577	1,352,577
17	Mamushë	5,507	121,867	130,202	130,202	136,390	136,390	136,390
18	Mitrovicë	71,909	1,591,303	1,700,144	1,700,144	1,780,940	1,780,940	1,780,940
19	Novobërdë	6,729	148,909	159,094	159,094	166,654	166,654	166,654
20	Obiliq	21,549	476,867	509,483	509,483	533,695	533,695	533,695
21	Pejë	96,450	2,134,381	2,280,367	2,280,367	2,388,737	2,388,737	2,388,737
22	Podujevë	88,499	1,958,430	2,092,382	2,092,382	2,191,818	2,191,818	2,191,818
23	Prishtinë	198,897	4,401,472	4,702,522	4,702,522	4,925,999	4,925,999	4,925,999
24	Prizren	177,781	3,934,188	4,203,276	4,203,276	4,403,028	4,403,028	4,403,028
25	Rahovec	56,208	1,243,850	1,328,926	1,328,926	1,392,080	1,392,080	1,392,080
26	Shtërpcë	6,949	153,777	164,295	164,295	172,103	172,103	172,103
27	Shtime	27,324	604,664	646,021	646,021	676,722	676,722	676,722
28	Skenderaj	50,858	1,125,457	1,202,436	1,202,436	1,259,579	1,259,579	1,259,579
29	Suharekë	59,722	1,321,612	1,412,007	1,412,007	1,479,110	1,479,110	1,479,110
30	Viti	46,987	1,039,794	1,110,914	1,110,914	1,163,707	1,163,707	1,163,707
31	Vushtrri	69,870	1,546,181	1,651,936	1,651,936	1,730,441	1,730,441	1,730,441
32	Zubin Potok	6,616	146,408	156,422	156,422	163,856	163,856	163,856
33	Zveçan	7,481	165,550	176,873	176,873	185,279	185,279	185,279
34	Graçanicë	10,675	236,231	252,389	252,389	264,383	264,383	264,383
35	Kllokot	2,556	56,563	60,432	60,432	63,303	63,303	63,303
36	Mitrovica Veriore	12,326	272,767	291,424	291,424	305,273	305,273	305,273
37	Partesh	1,787	39,545	42,250	42,250	55,316	55,316	55,316
38	Ranillug	3,866	85,552	91,404	91,404	95,748	95,748	95,748
Total		1,780,021	39,390,804	42,085,037	42,085,037	44,112,682	44,112,682	44,112,682

4.2.4 Projeksionet e të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2017-2019

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2017 bazuar në Tabelën 1 Makro në shumë prej 79 milion euro, inkorporohen si pjesë e KASH Komunal 2017-2019, si burim i financimit komunal bazuar në LFP. Shpërndarja e këtij projeksioni të të hyrave vetanake nëpër komuna është bazuar në rekomandimet e grupit punues i themeluar për këtë qëllim. Grupi punues ka propozuar shpërndarjen e projeksionit në bazë të parametrave: të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, si dhe të hyrat tjera komunale. Secilit parametër i është dhënë pesha specifike. Në bazë të këtyre parametrave, shpërndarja e projeksionit është përshtatur për disa komuna me realizimin e të hyrave në vitin 2015.

Tabela 21: Projeksionet e të Hyrave vetanake komunale për vitin 2017-2019

Nr.	Komunat	Të Hyrat Vetanake 2014	Të Hyrat Vetanake 2015	Të Hyrat Vetanake 2016	Të Hyrat Vetanake 2017	Plani i Të Hyrave Vetanake 2018	Plani i Të Hyrave Vetanake 2019
1	Deçan	434,348	636,892	642,835	1,309,444	1,309,444	1,326,019
2	Dragash	374,716	487,030	400,000	751,675	751,675	761,190
3	Ferizaj	3,575,463	4,204,689	4,160,320	4,472,188	4,472,188	4,528,798
4	Fushë Kosovë	2,288,351	1,822,756	2,350,000	3,035,973	3,035,973	3,074,403
5	Gjakovë	2,731,334	3,026,311	3,030,300	3,616,260	3,616,260	3,662,035
6	Gjilan	3,698,330	3,859,953	4,000,000	4,599,390	4,599,390	4,657,610
7	Gllogoc	1,412,710	1,200,874	1,500,000	1,474,005	1,474,005	1,492,663
8	Hani i Elezit	277,233	256,258	280,000	239,854	239,854	242,890
9	Istog	936,048	1,014,149	1,020,000	1,226,695	1,226,695	1,242,223
10	Junik	83,865	91,567	91,000	141,987	141,987	143,784
11	Kaçanik	533,685	695,757	709,672	861,014	861,014	871,913
12	Kamenicë	749,986	986,433	850,000	899,181	899,181	910,563
13	Klinë	916,415	857,767	1,028,000	1,030,521	1,030,521	1,043,566
14	Leposaviq	14,764	42,888	50,000	198,013	198,013	200,519
15	Lipjan	1,623,310	1,342,336	1,850,000	2,108,547	2,108,547	2,135,237
16	Malishevë	969,804	755,908	1,010,000	1,097,142	1,097,142	1,111,030
17	Mamusha	62,498	64,869	64,900	105,826	105,826	107,166
18	Mitrovicë	1,645,634	2,117,292	2,267,582	2,436,932	2,436,932	2,467,779
19	Novobërdë	166,321	204,672	190,000	218,829	218,829	221,599
20	Obiliq	1,045,796	811,716	900,000	1,044,713	1,044,713	1,057,937
21	Pejë	3,271,418	3,394,551	3,452,687	4,429,046	4,429,046	4,485,110
22	Podujevë	1,199,576	1,597,592	1,710,000	1,847,800	1,847,800	1,871,190
23	Prishtinë	19,904,415	27,162,609	30,000,000	24,607,375	24,607,375	24,918,861
24	Prizren	5,353,482	8,275,080	9,280,000	6,102,106	6,102,106	6,179,348
25	Rahovec	1,017,555	1,099,014	1,158,014	1,247,732	1,247,732	1,263,526
26	Shtërpcë	259,587	336,282	337,500	446,914	446,914	452,571
27	Shtime	350,677	445,503	451,788	573,460	573,460	580,719
28	Skenderaj	848,566	748,155	955,000	1,187,875	1,187,875	1,202,911
29	Suharekë	1,632,168	2,117,200	1,917,000	1,934,756	1,934,756	1,959,247
30	Viti	876,595	1,008,847	939,500	1,106,695	1,106,695	1,120,704
31	Vushtrri	1,369,708	1,675,327	1,703,418	2,316,735	2,316,735	2,346,061
32	Zubin Potok	8,680	42,888	50,000	90,486	90,486	91,631
33	Zveçan	16,454	42,888	50,000	102,771	102,771	104,072
34	Gracanicë	1,033,849	1,501,093	1,200,000	1,700,483	1,700,483	1,722,008
35	Kllokot	116,032	86,849	120,000	104,297	104,297	105,617
36	Mitrovica veriore	20,532	90,066	114,100	177,463	177,463	179,709
37	Partesh	30,655	46,384	46,384	42,483	42,483	43,021
38	Ranillug	115,973	92,768	120,000	113,334	113,334	114,769
	Total	**60,966,535**	**74,243,213**	**80,000,000**	**79,000,000**	**79,000,000**	**80,000,000**

Tabela 22: Të hyrat vetanake të realizuara nga komunat në vitet 2013-2016

Nr.	Komunat	Realizimi i THV në vitin 2013	Realizimi i THV në vitin 2014	Realizimi i THV në vitin 2015	Realizimi i THV në vitin 2016
1	Deçan	425,078	434,348	616,305	504,235
2	Dragash	357,140	374,716	349,061	384,617
3	Ferizaj	2,889,200	3,575,463	3,512,009	3,810,069
4	Fushë Kosovë	1,850,717	2,288,351	2,034,210	2,350,000
5	Gjakovë	2,370,061	2,731,334	2,581,208	2,943,514
6	Gjilan	3,289,104	3,698,330	3,627,759	3,870,932
7	Gllogoc	841,161	1,412,710	893,350	1,090,793
8	Hani i Elezit	248,848	277,233	223,522	225,328
9	Istog	848,542	936,048	941,134	971,569
10	Junik	75,190	83,865	77,579	73,958
11	Kaçanik	404,277	533,685	556,372	555,764
12	Kamenicë	642,124	749,986	759,595	765,488
13	Klinë	757,513	916,415	790,640	749,027
14	Leposaviq	2,245	14,764	19,874	
15	Lipjan	1,202,415	1,623,310	1,453,652	1,650,000
16	Malishevë	581,737	969,804	586,364	739,167
17	Mamusha	41,367	62,498	52,763	51,423
18	Mitrovicë	1,368,877	1,645,634	1,517,743	1,852,301
19	Novobërdë	153,322	166,321	187,188	215,406
20	Obiliq	800,456	1,045,796	1,043,716	740,023
21	Pejë	3,003,047	3,271,418	3,337,519	3,118,162
22	Podujevë	1,005,192	1,199,576	1,180,318	1,367,390
23	Prishtinë	21,748,614	19,904,415	18,035,992	22,051,668
24	Prizren	4,002,240	5,353,482	5,275,953	5,533,931
25	Rahovec	842,364	1,017,555	969,696	1,000,914
26	Shtërpcë	160,129	259,587	231,679	258,015
27	Shtime	299,305	350,677	334,729	431,039
28	Skenderaj	693,486	848,566	702,249	896,251
29	Suharekë	1,453,778	1,632,168	1,815,740	1,633,848
30	Viti	668,186	876,595	781,607	847,135
31	Vushtrri	1,213,179	1,369,708	1,400,925	1,294,943
32	Zubin Potok	3,747	8,680	6,531	
33	Zveçan	718	16,454	10,603	
34	Gracanicë	1,372,948	1,033,849	1,699,488	1,200,000
35	Kllokot	97,693	116,032	91,726	110,443
36	Mitrovica veriore	10,612	20,532	27,400	42,361
37	Partesh	24,991	30,655	41,486	34,608
38	Ranillug	82,587	115,973	112,337	120,000
Total		**55,832,194**	**60,966,535**	**57,880,021**	**63,484,320**

4.2.5 Përmbledhje e financimit komunal për 2017-2019

Për ndarjen e granteve qeveritare sipas komunave për vitin 2017 janë zbatuar kriteret dhe formulat bazë të përcaktuara në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal si dhe bazuar në Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale dhe të dhënave nga ministritë e linjës.

Komisioni i Granteve në takimin e datës 21 prill 2016 ka aprovuar grantet qeveritare për financimin e komunave përfshirë projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2017, ku total burimet e financimit komunal janë aprovuar në shumën prej 439.96 milion euro (tabela 7).

Granti i Përgjithshëm për vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 ka një rritje prej 14.29 milion euro si rezultat i rritjes së të hyrave të përgjithshme.

Granti specifik për arsim parauniversitar për vitin 2017 ka një rritje prej 2.1 milion euro në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime krahasuar me vitin 2016 edhe përkundër zvogëlimit të numrit të nxënësve të raportuar nga MASHT për vitin 2017, atëherë kjo nënkupton se financimi për kokë nxënësi është rritur krahasuar me vitin 2016.

Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2017 ka një rritje prej 2 milion euro krahasuar me vitin 2016.

Financimi për shëndetësinë sekondare për vitin 2017 është në nivel të njëjtë me vitin paraprak, po ashtu financimi për shërbimet rezidenciale pas bartjes së kompetencave me procesin e planifikimit të buxhetit për vitin 2016 nga MPMS në komunat e cekura si në tabelë është i njëjtë me vitin paraprak. Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2017 krahasuar me vitin paraprak janë përafërsisht në nivelin e njëjtë.

Tabela 23: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2017-2019 për komunat

Përshkrimi	2014	2015	2016	2017	2018	2019
1. Grantet qeveritare	319.4	339.1	338.32	354.61	360.31	367.91
Granti i përgjithshëm	137.5	145.7	134.91	149.20	154.90	162.50
Granti i përgjithshëm	127.8			145.20		
Kontigjenca për korrektim	9.7			4.00		
Granti specifik për shëndetësi	39.4	42.08	42.08	44.11	44.11	44.11
Granti specifik për arsim	142.5	151.3	161.33	163.43	163.43	163.43
2. Grantet për kompetencat e	1.8	2.60	2.60	2.60	2.60	2.60
Kujdesi shëndetësor dytësor	1.8	2.60	2.60	2.60	2.60	2.60
3.Transferi i Shërbimeve	0.24	0.24	0.24	1.62	1.62	1.62
Shërbimet rezidenciale	0.24	0.24	0.24	1.62	1.62	1.62
4. Të hyrat vetanake komunale	60.9	74.2	80.00	79.00	79.00	80.00

TOTAL FINANCIMI KOMUNAL	382.3	416.1	421.16	439.96	445.66	454.26

Grafiku 23: Ecuria e granteve qeveritare komunale sipas viteve 2014-2019 (mil.€)



4.3 Komisioni i Granteve

Komisioni i Grandeve ushtron përgjegjësitë dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 03/L-049 mbi Financat e Pushtetit Lokal (LFPL).

Komisioni i Granteve ka këto përgjegjësi:

a. Të bëjë shqyrtimin e formulës për ndarjen e granteve si dhe t'i rekomandojë Qeverisë propozim ndryshime dhe plotësime për këtë formulë, e cila më pas i'a përcjell Kuvendit rekomandimet e Komisionit të granteve së bashku me pëlqimin e Qeverisë ose arsyet për refuzimin e rekomandimeve nga Qeveria;

b. Në bazë vjetore të përcaktojë formulës për ndarjen e Grantit Specifik për Arsim dhe Grantit Specifik për Shëndetësi në përputhje me parimet e parashtruara në nenin 25 të ligji nr. 03/L-049(LFPL);

c. Deri më 31 Mars të çdo viti kalendarik, të përgatisë dhe t'i dorëzojë Qeverisë një raport për vitin e shkuar kalendarik në të cilin bëhet vlerësimi i përshtatshmërisë së sistemit financiar;
d. Të bëjë shqyrtimin e ankesave nga komunat lidhur me zbatimin e kësaj formule, duke përfshirë financimin e kompetencave të deleguara ose të shtuara, si dhe t'i rekomandojë Qeverisë propozim-masa në këtë drejtim;
e. Të përgatisë rekomandime për alokimin e shumave plotësuese (shtesë) ato komuna të cilave i'u janë dhënë kompetenca të shtuara sipas neneve 19 deri 22 të Ligjit mbi Vetë-Qeverisjen Lokale, për t'u mundësuar këtyre komunave ushtrimin e rregullt të kompetencave të tyre të shtuara;
f. Të monitorojë miratimin e të dhënave pas regjistrimit të popullsisë si dhe zbatimin e klauzolës së mos-dëmtimit, në përputhje me nenin 35 të këtij ligji, si dhe të përgatisë rekomandimet për arritjen e qëllimit të atij neni;
g. Të bëjë shqyrtimin e propozim shpenzimeve kapitale të buxhetuara për komunat nga organizatat buxhetoere të Qeverisë së Kosovës, të cilat i dorëzohen Komisionit nga Ministri i Financave, si dhe të përgatisë rekomandime për Qeverinë lidhur me këtë;
h. Të bëjë shqyrtimin e kërkesave nga komunat për financim shtesë për përmbushjen e nevojave të jashtëzakonshme, si dhe t'i rekomandojë Qeverisë masa në këtë drejtim; dhe
i. Të mbështesë Ministrin e Financave dhe Ministrin e Pushtetit Lokal si dhe autoritetet e tjera publike në sigurimin e zbatimit të LFPL.

Komisioni i Granteve themelohet në bazë të këtij ligji dhe ka përbërjen si vijon:
(i) Kryeministri ose përfaqësuesi i tij,
(ii) Ministri i Financave,
(iii) Ministri i Pushtetit Lokal,
(iv) një ministër tjetër i caktuar nga Qeveria,
(v) Kryesuesi i Komisionit për Buxhet të Kuvendit, dhe
(vi) katër kryetarë të komunave, njëri ndër të cilët duhet të jetë kryetari i një komune minoritare.
Zgjedhja e kryetarëve të komunave bëhet përmes dy shorteve të veçanta, të cilat mbahen në bazë vjetore nga Komisioni i Granteve në një takim të hapur.
Komisioni i granteve mban takime të rregullta të cilat thirren nga Ministri i Financave, së paku një herë në çdo tremujor kalendarik.

Takimi i Komisionit të Granteve mund të mbahet ose të vazhdohet në mënyrë të vlefshme vetëm nëse gjashtë ose më shumë anëtarë janë të pranishëm dhe Ministri i Financave ose Kryeministri është ndër të pranishmit.

Nëse Kryeministri është personalisht i pranishëm, ai e kryeson takimin e Komisionit të Granteve, e nëse jo, atëherë takimin e kryeson Ministri i Financave.

Kuorumi prej së paku gjashtë anëtarëve nevojitet në mënyrë që një çështje të hedhet në votim. Nëse Komisioni i Granteve nuk mund të vendosë mbi një çështje të caktuar me shumicë votash, kjo çështje do të vendoset nga Kryeministri ose – nëse Kryeministri nuk është personalisht i pranishëm në takim – Ministri i Financave.

Vendimet dhe rekomandimet e miratuara nga Komisioni i Granteve publikohen në faqen e internetit të Ministrisë së Financave. Komisioni i Granteve, mundet, me shumicë votash, të dakordohet që t'i mbajë diskutimet mbi një çështje të caktuar në mënyrë konfidenciale.

4.4 Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për komuna 2017-2019

Struktura e kategorive ekonomike operative për komunat për vitin 2017 është në nivelin e njëjtë krahasuar me vitin 2016 me një rritje prej 2.1 milion euro tek kategoria ekonomike mallëra dhe shërbime, ndërsa kategoria ekonomike për shpenzime kapitale ka një rritje prej 15.8 milion euro si rezultat i rritjes së grantit të përgjithshëm për vitin 2017 krahasuar me vitin 2016.

Tabela 24: Struktura e shpenzimeve për buxhetin komunal për vitin 2017-2019

Grafiku 24: Struktura e shpenzimeve Komunale për vitin 2017 (në %)

V. Përgatitja e Propozim-Buxhetit

Përgatitja dhe rishqyrtimi i propozim-buxheteve dhe kërkesave për ndarje buxhetore rregullohet dhe përcaktohet me Nenin 20 të LMFPP.

Ministri i Financave është i autorizuar dhe përgjegjës që të nxjerrë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore, me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

Në ose para datës së 5 Majit të vitit aktual fiskal, Ministri duhet t'u dërgojë Zyrtarëve Kryesor Financiar të të gjitha organizatave buxhetore një ose më shumë qarkore buxhetore më të cilat sigurohen informata dhe udhëzime:

(i) tavanet e shpenzimeve, të përcaktuar në KASH, për organizatën përkatëse buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal dhe vlerësimet jo të detyrueshme për dy vitet e ardhëshme fiskale,

(ii) për komunën, nivelin e granteve të përcaktuar në KASH dhe të llogaritur në bazë të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL), dhe

(iii) metodologjinë dhe formularët të cilët duhet shfrytëzuar nga organizata buxhetore gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit dhe kërkesës së saj për ndarje buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal.

Qarkoret buxhetore duhet të përfshijnë:

- procedurat që duhet të përdoret nga organizata buxhetore gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit dhe kërkesës së saj për ndarje buxhetore;
- informatat që duhet të parashtrohen në propozim-buxhet dhe në kërkesën për ndarje buxhetore;
- detaje mbi formatin në të cilin duhet të përgatitet propozim-buxheti dhe kërkesa për ndarje buxhetore;
- datën deri në të cilën organizata buxhetore duhet të përfundojë dhe dorëzojë në Ministri propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore ; dhe
- udhëzime ose informata të tjera të cilat Ministri i konsideron të nevojshme.

Ministri duhet të nxjerrë qarkoren e parë buxhetore deri me 15 Maj të vitit aktual fiskal. Data në të cilën komunat duhet t'i përfundojnë dhe dorëzojnë propozim-buxhetet dhe kërkesat e tyre për ndarje buxhetore është 30 Shtatori i atij viti. Për organizatat buxhetore të cilat nuk janë komuna,

afati i fundit kohor për dorëzimin e këtyre dokumente është afati i përcaktuar në qarkoren buxhetore. Kur azhurnimi i KASH-it ndikon në shumat e vlerësuar të granteve qeveritare të përcaktuara në pikën (j) të paraagrafit 1 të nenit 19 të LMFPP, Ministri (Ministria e Financave), jo më vonë se me 15 Gusht të vitit aktual fiskal, nxjerrë një qarkore buxhetore për komunat në të cilat siguron udhëzimet përfundimtare buxhetore dhe nivelet përfundimtare të granteve në përputhje me ato të përcaktuara në KASH-in e azhurnuar dhe të llogaritura në përputhje me Ligjin e Financave të Pushtetit Lokal.

Secila organizatë buxhetore është përgjegjëse që të përgatisë dhe t'i dorëzoje Ministrit, propozim-buxhetin dhe kërkesën e saj për ndarje buxhetore në pajtim me

(i) tavanin e zbatueshëm të shpenzimeve,

(ii) informatat dhe udhëzimet në qarkoren(et) buxhetore; dhe

(iii) në rastin e komunës, shumat e aplikueshme të granteve të llogaritura me formulën e përcaktuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal.

As Ministri dhe as Qeveria nuk duhet të bëjnë ndryshimin e një propozim-buxheti ose kërkese për ndarje buxhetore të dorëzuar nga një komunë nëse dhe është miratuar nga kuvendi komunal. Nëse një propozim-buxhet ose kërkesë për ndarje buxhetore e dorëzuar nga një komunë nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 20.4, Ministri i'a kthen këto dokumente kryetarit dhe kuvendit të komunës përkatëse së bashku me një shpjegim të magësive të cilat duhet të përmirësohen. Nëse, deri në datën e përcaktuar në Nenin 20.3 (30 Shtator), komuna nuk e ka dorëzuar propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore të cilat janë në përputhje me këto kushte, atëherë zbatohen dispozitat e Nenit 62 te LMFPP. Neni 62 rregullon Mos dorëzimi me kohë i propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore nga komuna, sipas të cilit nëse kryetari i komunës dështon që t'ia dorëzojë Kuvendit Komunal propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore deri me 1 Shtator të vitit aktual fiskal, Ministri menjëherë bën emërimin e një administratori financiar komunal për komunën në fjalë dhe pas këtij emërimi, të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë të cilat i janë dhënë kryetarit të komunës sipas këtij ligji ose LFPL shndërrohen në të drejta dhe përgjegjësi të administratorit financiar komunal; dhe Kryetari i komunës i nënshtrohet procedurave të përcakturara në Ligjin për Vetë-Qeverisjen Lokale.

Nëse kuvendi komunal dështon që me kohë të bëjë miratimin dhe dorëzimit te Ministri të propozim-buxhetit komunal dhe kërkesës për ndarje buxhetore të cilat janë në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë ligj deri në datën 30 Shtator, Ministri është i autorizuar që të përgatitë

propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore për këtë komunë të cilat bazohen, mirëpo nuk janë më të mëdha se, buxheti dhe ndarjet buxhetore të komunës për vitin ekzistues fiskal.

Nëse – pas datës sëhtator, mirëpo para se Kuvendi të ketë bërë miratimin e BKK-së dhe Ligjit për Ndarjet Buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal – kuvendi komunal miraton dhe i dorëzon Ministrit propozim-buxhetin komunal dhe kërkesën për ndarje buxhetore, Ministri duhet që menjëherë t'ia dorëzojë këto dokumente Qeverisë e cila menjëherë i'a dorëzon këto dokumente Kuvendit.

Nëse kuvendi komunal dështon që ta miratojë dhe t'ia dorëzojë Ministrimit propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore deri me 1 Mars, atëherë asnjë shpenzim nuk duhet të bëhet nga ose në emër të komunës në fjalë deri në kohën kur kuvendi komunal ta miratojë dhe t'ia dorëzojë Ministrit këto dokumente. Pas miratimit dhe dorëzimit të këtyre dokumenteve te Ministri nga kuvendi komunal, Ministri duhet që menjëherë t'ia dorëzojë këto dokumente Qeverisë e cila menjëherë i'a dorëzon këto dokumente Kuvendit. Kuvendi mundet, mirëpo nuk është i detyruar, që ta ndryshojë BKK-në dhe Ligjin për Ndarjet Buxhetore për t'i pasqyruar dokumentet e dorëzuara.

Nëse deri në datën e përcaktuar në Qarkoren Buxhetore, një agjenci e pavarur nuk dorëzon me kohë propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore, atëherë zbatohen dispozitat e paragrafit 1 te Nenit 66 (sipas të cilit, gjatë procesit të buxhetimit për një agjenci të pavarur me të hyra të përcaktuara, as Ministri dhe as Qeveria nuk janë të autorizuara që të bëjnë ndryshimin e propozim-buxhetit ose kërkesës për ndarje buxhetore të një agjencie të pavarur ose gjykatave, nëse ky document është dorëzuar deri në datën e përcaktuar në Qarkoren Buxhetore dhe në përputhje me formën e kërkuar në Qarkore. Nëse dokumenti nuk i është dorëzuar Minisrit deri në datën e përcaktuar, Ministria është i autorizuar që të përgatisëë propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore, të cilat duhet të bazohet, mirëpo most ë jenë më shumë se buxheti dhe kërkesa për ndarje buxhetore për vitin actual fiscal).

Për propozim-buxhetet dhe kërkesat për përvetësime të dorëzuara nga organizatat buxhetore të cilat nuk janë agjenci të pavarura dhe komuna, pas skadimit të afatit kohor të përcaktuar me LMFPP, Departamenti i Buxhetit duhet të marrë të gjitha masat, të cilat mund të jenë të nevojshme për t'i sjellë këto dokumente dhe t'ia dorëzojë këto dokumente Ministrit, së bashku me rekomandimet e Departamentit të Buxhetit.

Para datës 31 Tetor, Ministri duhet të përgatisë dhe t'i dorëzojë Qeverisë

(i) propozim-Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësime jo të detyrueshme për secilin nga dy (2) vitet e ardhshme fiskale,
(ii) Propozim Ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal, dhe
(iii) KASH-in e azhuruar.

Kalendari kohor i procesit buxhetor - përmban hollësi të veprimeve rreth politikave dhe hapave proceduralë që MF-i i kërkon për çdo vit nga organizatat buxhetore, përfshirë këtu kërkesat për informata dhe ato që lidhen me afatet kohore ligjore të procesit buxhetor. Ky orar kohor është i bazuar në kërkesat e LMFPP-se dhe rikonfirmohet në qarkoret vjetore buxhetore të MF-së. Orari kohor ofron datat e fundit deri kur duhet kompletuar veprimet, por nuk pengon kompletimin e veprimeve edhe para afatit. Organizatat buxhetore duhet t'i respektojnë kërkesat dhe afatet kohore, në mënyrë që procesi buxhetor i Kosovës të jetë efektiv.
Veç kësaj, kjo do t'u mundësojë organizatave buxhetore një pjesëmarrje më aktive dhe më të suksesshme në procesin buxhetor mbarë-qeveritar gjatë kursit të plotë të ciklit buxhetor.
Hapii parë në përgatitjen e buxhetit për 2017-2019 është bërë me aprovimin e KASH-it 2017-2019 nga Qeveria dhe dërgimi në Kuvendin e Kosoves,hapi tjeter është lëshimi i Qarkores Buxhetore 2017/01. Pjesa në vijim prezanton kalendarin kohor të buxhetit, hapat dhe veprimet gjate procesit buxhetor për 2017-2019 për Organizata Buxhetore të nivelit qendror dhe për komunat.
Kalendari kohor për nivelin Qendror - Organizatat buxhetore të nivelit qendror duhet t'i përmbahen ketij kalendari kohor në përgatitjen e buxhetit të tyre:

- 20 Qershor: Organizatat buxhetore dorëzojnë në MF kerkesat buxhetore sipas dokumentacionit përkatës, sipas programeve dhe kategorive ekonomike. Kërkesat buxhetore duhet të jenë plotësisht të arsyetuara përmes përdorimit të sistemit të BDMS-së dhe PIP-it;
- 24 Qershor: Departamenti i makroekonomisë paraqet kornizën e re makro-fiskale;
- 30 Qershor: Qarkorja buxhetore 2017/02 do të leshohet sipas nevojës dhe do të adresoj vetëm çështjet specifike të reja të cilat kanë rezultuar pas lëshimit të Qarkores së parë buxhetore;
- 14 Korrik: Nëse kërkohen informata shtesë sipas Qarkores së dytë buxhetore, atëherë këto informata duhet të dorëzohen nga Organizatat buxhetore në Ministrinë e Financave, Departamentin e Buxhetit deri në këtë datë;
- 29 Gusht - 2 Shtator: Dëgjimet buxhetore (pas pranimit të materialeve nga organizatat buxhetore). Pjesëmarrës në dëgjime do të jenë zyrtarët të organizatave buxhetore, stafi i MF,

Zyra e Kryeministrit, përfaqesues të Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa. Orari i dëgjimeve buxhetore do ti bashkengjitet Qarkores buxhetore 2017/02. Nëse është e mundur në këto dëgjime, do të shikohet mundësia e arritjes së marrëveshjes për shumat totale të buxhetit të organizatës suaj për vitin 2017;

- 8 Shtator: Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Fiskale në MF paraqet vlerësimet e fundit për indikatorët makro-ekonomik, posaqërisht indikatorët që lidhen me procesin buxhetor 2017-2019;
- 12 Shtator - 16 Shtator: konsultimet në Qeveri për caktimin e kufijve final buxhetorë;
- 19 Shtator: nxjerrja e Qarkores së tretë buxhetore me kufijtë final buxhetorë;
- 26 Shtator - 28 Shtator: Ankesat nga Organizatat Buxhetore;
- 29 Shtator - 30 Shtator: Takimet e Qeverisë për ti shqyrtuar ankesat e organizatave buxhetore;
- 13 Tetor: Drafti i parë i buxhetit dhe dërgimi i këtij drafti në Qeveri;
- 14 Tetor - 26 Tetor: miratimi final i Draft Buxhetit në Qeveri;
- 28 tetor: Dorëzimi i Draft Buxhetit 2017 në Kuvendin e Republikës së Kosovës në përputhje me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Kalendari kohor për nivelin komunal - Organizatat buxhetore të nivelit lokal duhet t'i përmbahen këtij kalendari kohor në përgatitjen e buxhetit të tyre:

- 30 Qershor: aprovimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit për komuna;
- 30 Shtator: Aprovimi i buxhetit komunal për 2017-2019 në Kuvendin Komunal;
- 30 Shtator: pas aprovimit të propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal, komunat janë tëobliguara të dorëzojnë në Ministrine e Financave dokumentet si në vijim:
    - Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga KuvendiKomunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).
    - Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunalpër vitin 2017-2019, përfshirë projektet kapitale shumevjeçare.
    - Tabelat e buxhetit komunal (BDMS dhe PIP): Tabela 4.1, 4.2 dhe 4.3.

5.1 Kufijtë Buxhetorë

Element kyç i procesit buxhetor është përcaktimi i kufirit buxhetor për secilën organizatë buxhetore. Kufijtë janë realitet i jetës për secilën qever, asnjëherë nuk ka mjaft para për të bërë të gjitha ato që dëshirohen nga organizatat buxhetore, prandaj duhet përcaktuar kufijtë përbrenda kontekstit të buxhetit të gjithmbarshëm, me qëllim të sigurimit që Qeveria nuk do të shpenzojë më tepër para nga sa janë në dispozicion.

Organizatë buxhetore që ka pranuar para nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës duhet të krijojnë dhe të ruajnë procesin e konstatimit të nevojave të tyre financiare, planifikimit të duhur të kërkesave për fondet e programeve dhe të themelojnë disiplinën fiskale, për të punuar me fondet që pranohen dhe për të siguruar që buxheti nuk do të mbishpenzohet.

Kufijtë duhet të përcaktohen në mënyrë transparente dhe nga niveli qendror për secilës Organizatë Buxhetore pas nje analize te mirfillt të kërkesave buxhetore.

Kufiri e butë - fillimisht kufijt buxhetore lëshohen si total në kuadër te organizatës buxhetore, kufij te cilët organizatat buxhetore kanë fleksibilitetin e nevojshëm për lëvizje të fondeve përbrenda kategorive ekonomike, për aq sa ato nuk tejkalojnë kufirin e gjithmbarshëm dhe për aq sa ndryshimet e bëra nuk e obligojnë Qeverinë të bëjë rritje të papritura të shpenzimeve në vitet vijuese.

Ky kufi mund t'u nënshtrohet përshtatjeve nëse organizata ofron arsyetime të mira në dëgjimet buxhetore, por nëse ato dorëzojnë kërkesa që tejkalojnë shumën e kufirit, organizatat buxhetore nuk duhet të supozojnë që fondet shtesë do të jenë në dispozicion.

E rëndësishme është që organizatat buxhetore të jenë të njoftuara për kufijt para se të kenë filluar me punën për përgatitjen e buxhetit, për të shmangur humbjen e kohës në përgatitje të buxhetit.

Kufijtë e fortë - kufijt final për secilën organizatë buxhetore, plus cilado "rezervë" e mbajtur nga MF-i, do të jenë baras me shumën totale të fondeve të gjithmbarshme në dispozicion.

Kjo shifër, madje edhe në formë të kufirit "të fortë", nuk është një shifër e garantuar për Organizatën Buxhetore, pasi që mund të shtrohet nevoja për ndryshime para se të jetë bërë aprovimi i ndarjeve buxhetore për vitin vijues, në rast të ndryshimit të rrethanat përcaktuese të resurseve të gjithmbarshme buxhetore, alokimit të resurseve, paraqitjes së shpenzimeve shtesë për politika të reja apo legjislacion, etj.

5.2 Qarkoret buxhetore

Qarkoret buxhetore jan dokumente udhëzuese për organizatat buxhetore, përmes të cilave organizatat buxhetore njoftohen për hapat që duhet ndërmarrë ne vijim dhe për orarin kohor që duhet ndjekur për hartimin e buxhetin të tyre për vitin vijues.

Varësisht nga rrethanat në të cilat përgatitet buxheti i secilit vit, mund të jenë dy apo më tepër qarkore buxhetore që lëshohen brenda vitit, por qarkorja e parë buxhetore duhet të nxirret nga Ministri e Financave deri më 15 maj. Secila përshkruan kërkesat dhe procedurat që lidhen me fazat e ndryshme apo aspektet e ciklit buxhetor. Qarkoret bëjnë përshkrimin e politikave të gjithmbarshme që do të ndiqen, orarin kohor, ngjarjet që do të zhvillohen, si dhe informatat që duhet mbledhur dhe prodhuar për përgatitjen e buxhetit.

Qarkoret buxhetore formojnë bazën në të cilën mbështetet i tërë procesi për formulimin e buxhetit, prandaj zbatimi i drejtpërdrejtë dhe i suksesshëm i tyre do t'u mundësojë analistëve të buxhetit plotësimin e pjesëve vitale të roleve dhe përgjegjësive të tyre në mënyrë efektive, andaj MF-i përpiqet të nxjerrë qarkoret në një fazë të hershme të procesit buxhetor, për të shtuar në maksimum kohën në dispozicion të organizatave buxhetore. Organizatat buxhetore duhet t'i kenë këto informata rreth kufijve sa më parë që është e mundur, për ti mundësuar atyre qe te zhvillojn procesin e brendshëm buxhetore. Mirëpo si është cekur shpesh në këtë udhëzues, organizatat buxhetore kanë interes të qartë në përmbushjen e kërkesave të procesit buxhetor, pavarësisht nga datat e lëshimit të instruksioneve nga MF-i. Prandaj, organizatat buxhetore efektive gjithmonë duhet themeluar dhe mirëmbajtur kalendarin intern të planifikimit të buxhetit për t'u siguruar që nevojat e programeve të tyre janë të përfaqësuara në mënyrë sa më efektive në kuadër të procesit buxhetit.

Qarkorja e Parë buxhetore siguron sfondin e përgjithshëm dhe mjedisin e politikave në të cilin përgatitet buxheti, si dhe orarin kohor që duhet respektuar, dhe siguron formatin e domosdoshëm që duhet ndjekur. Ajo tregon në pika të gjera çfarë pritet nga organizatat buxhetore. Në disa raste mund të sigurohen kërkesa teknike dhe udhëzime shumë të hollësishme.

Ndërsa sa i përket nivelit komunal me qarkoren e pare buxhetore lëshohen kufijet e financimit komunal për secilën komuna, kufij të cilët paraprakisht aprovohen nga Komisioni i Granteve dhe janë pjesëintegrale eKASH-it komunal. Ne qarkoren e pare buxhetore epen te gjitha sqarimet rreth kritereve te aplikuara gjat kalkulimit te granteve qeveritare per nivelin komunal, Po ashtu me ket

qarkore buxhetore epen të gjitha udhëzimet që duhet nderrmar komuna per të zhvilluar procesin buxhetore (procesin intern buxhetor)

Qarkorja e Dytë ofron hollësi për kufijtë e fortë dhe azhurnimin e orarit fillestar kohor (d.m.th. specifikon datën deri në të cilën duhet dorëzuar parashtrimet buxhetore dhe kur do të mbahen Dëgjimet Buxhetore, në mes të tjerash). Sa i përket nivelit komunal me ket qarkore përcaktohet struktuara e shpenzimeve komunale dhe udhëzimet te tjera rret përgaditjes së propozim buxhetit komunal.

Qarkoret e tjera pasuese mund të bëjnë adresimin e çështjeve speciale dhe përfundimtare për përmbylljen e procesit buxhetor, apo informatat lidhur me proceset buxhetore për qëllime speciale.

5.3 Sistmet për planifikim të buxhetit

Ekzistojn dy sisteme elektronike për planifikim të buxhetit:

- Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit dhe
- Sistemi i Programit të Investimeve Publike

5.3.1 Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit - SZHMB (BDMS)

Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit është sistem financiar i cili merret me formulimin e buxhetit dhe planifikimin e shpenzimeve buxhetore. Sistemi SZHMB menaxhohet nga Departamenti i Buxhetit por eshte në shfrytëzim nga të gjitha Organizatat Buxhetore për planifikimin e shpenzimet operative siq janë: paga dhe meditje, mallëra dhe shërbime, shpenzimet e komunalive, subvencionet dhe transferet dhe rezerva. Organizatat Buxhetore i planifikojnë shpenzimet e tyre sipas niveleve.

SZHMB aktualishtë operon me këto nivele siç janë:

- PCF - 4 paraqet organizatën buxhetore;
- PCF - 3 paraqet departamentet, programet;
- PCF - 2 paraqet nën-programet; dhe
- PCF - 1 paraqet institucionet e caktuara buxhetore (shkollat, spitalet apo instituzione tjera).

Të gjitha Organizatat Buxhetore të dhënat e tyre të shpenzimeve i shkruajnë-paraqesin në nivel të PCF- 1 dhe PCF - 2, pastaj sistemi në mënyrë automatike i konsolidon (mbledhë) shpenzimet një nivel më lartë e që është PCF - 3 dhe më pas në të njëjtën mënyrë edhe një nivel më lartë e që është niveli i organizatës buxhetore (PCF - 4).

Në vijim gjeni të bashkangjitur një shembull se si duket një PCF (gjenerim i nje raporti)

Shembull i gjenerimit të Raportit në PIP

Date: 06.02.2017

Republika e Kosovës | Republika Kosova | Republic of Kosova
Qeveria e Kosovës | Kosova Vlada | Government of Kosova
Ministria e Financave | Ministarstvo Financija | Ministry of Finance

Lista e të gjitha projekteve

Mitrovicë

Prog	Kodi i Prop	Emri i Projektit	Lokacioni	Buxh Origjinal	10 - BKK	21 - THV	Vlerësuar për	Vlerësuar për	Totali
				2016	2017	2017	2018	2019	2016 - 2019
642166 - Inspekcioni									
	642166-1422822	Trajtimi i mbetjeve te ngurta dhe mb.urbane	Mitrovice	0	0	0	0	0	350,000
	642166-1523828	Largimi i deponive te egra	Mitrovice	50,000	15,000	45,000	0	0	105,000
	642166-1523854	Rrenimi i objekteve pa leje	Mitrovice	48,000	50,000	50,000	0	0	260,000
	642166-1730067	Rrenimi i objekteve pa leje	Mitrovice	0	15,000	40,000	12,000	12,000	79,000
		Totali		475,000	80,000	135,000	12,000	12,000	794,000
642169 - Zyra e Kuvendit Komunal									
	642169-1422550	Blerja e llaptopave per delegatet e kuvendit.	Mitrovice	0	0	0	0	0	10,000
		Totali		0	0	0	0	0	10,000
642175 - Buxhet dhe Financa									
	642175-1422856	Bashkfinancim me donator të mbrenshem dhe të jashtëm	Mitrovice	535,379	141,175	0	148,874	0	1,053,474
	642175-1523857	Bashkfinansim me donatoret e brendshem dhe te jashtem	Mitrovice	0	0	0	0	0	278,046
	642175-1730089	Bashkfinancim me donator te jashtem dhe te mbrendshem	Mitrovice	0	0	400,000	610,295	739,350	1,749,645
	642175-1627562	Softwer per per menaxhimin e kontratave,personelit dhe kontrabilitetit	Mitrovice	30,000	0	0	0	0	30,000
		Totali		515,379	141,175	400,000	759,169	739,350	3,111,165
642180 - Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjenca									
	642180-1422458	Pastrimi i shtratit te l.Lushta	Mitrovice	0	0	0	0	0	20,000
	642180-1730026	Asfaltimi,rregullimi dhe riparimi i rrugve	Mitrovice	0	0	0	0	0	0
	642180-1729950	Ndertimi i rrugve ne fshatin Vinarc		0	0	0	0	0	0
	642180-1729843	Ndertimi i rrjetit te ujesjellesit	Mitrovice	0	0	0	0	0	0
	642180-1627056	Ndertimi i garazhave per automjete te zjarrfiksve	Mitrovice	0	7,000	0	7,000	0	39,498
		Totali		25,498	7,000	0	7,000	0	59,498
642470 - Bujqesia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural									
	642470-1523931	Rregullimi i shtratit te lumit "Sitnica,Trepqa dhe Lushta"	Mitrovice	0	0	45,000	0	0	140,000

Page 1

Procedurat e sistemit PIP - Qeveria është e zotuar në përmirësimin e vazhdueshëm të ofrimit të shërbimeve publike. Një pjesë e madhe e kësaj është që të sigurohet që fondet publike të shpenzohen në aktivitete të cilat sigurojnë dobinë më të madhe për shoqërinë dhe se ato shpenzohen në mënyrën më efektive.

Një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve të Qeverisë është për qëllime investive. Investimet mund të definohet si sakrifikimi i përfitimeve apo shpërblimeve aktuale për të ndjekur një aktivitet duke pritur përfitime apo shpërblime më të mëdha në të ardhmen.

Investimet publike janë alokim i fondeve publike për projekte të cilat do të ngrisin produktivitetin ekonomik dhe social të vendit.

Një projekt mund të definohet si aktivitet i veçantë, me një pikë të veçantë të fillimit dhe me një pikë të veçantë mbarimi, i synuar që të arrijë objektiva të veçanta. Zakonisht, është një aktivitet i vetëm mjaft i ndryshëm nga aktivitetet paraprirëse dhe mund të jetë i ndryshëm nga ato pasuese, e jo thjeshtë një 'segment' i një programi të vazhdueshëm. Nganjëherë shpenzimi i investimit është aktivitet rutinor (p.sh përvetësimi i pajisjes administrative), por pjesa më e madhe e shpenzimit të investimit përbëhet nga projektet.

Projektit duhet të identifikohen nga procesi i planifikimit strategjik dhe duhet të kontribuojnë në arritjen e politikave të qeverisë dhe të strategjive sektoriale. Organizatat Buxhetore gjithashtu mund të kenë planet e tyre strategjike të cilat përkrahin strategjitë sektoriale.

Për të arritur investim efektiv dhe efikas, investimet e propozuara duhet të analizohen tërësisht, investimet të mbështesin prioritetet e qeverisë, të identifikohen mënyrat më përfituese të shpenzimeve (apo më efektive për shpenzimet) për të arritur outputet dhe objektivat e investimit dhe të jepet siguri të probabilitetit të lartë të suksesit.

Pasi projektet të jenë miratuar dhe financuar, implementimi i projektit duhet të monitorohet në mënyrë që të sigurojë progresin sipas planit dhe çfarëdo variacionesh në planin e projektit të cilat mund të ndikojnë kostot dhe beneficionet e parashikuara të projektit. Dërgesa e mëpasme e output-eve (prodhimeve) poashtu duhet të matet kundrejt atyre të specifikuara që në fazën e formulimit të projektit, në mënyrë që të ekzaminojë suksesin e projektit ashtu edhe të nxjerrë mësim për projektet e ardhshme në fushat e ngjashme.

Cikli buxhetor - Procedurat dhe sistemi i PIP-it është i dizajnuar për të përkrahur Qeverinë gjatë ciklit të planifikimit të buxhetit dhe gjatë ekzekutimit të buxhetit. Në diagramin e dhënë më poshtë

paraqiten afatet e përafërta të aktiviteteve kyçe që duhet të ndërmerren gjatë vitit. Në rastet kur aktiviteti është i paraqitur si shigjetë (p.sh. formulimi i projektit), aktiviteti i tillë mund të ndodhë në çfarëdo kohe gjatë vitit – mirëpo, ekzistojnë disa periudha kur aktiviteti ka gjasa të ndodh siç është dhënë në afatet e dhëna aty.



Orari për planifikim dhe buxhetim në Qeverinë e Kosovë

5.4 Institucionet Ndërkombëtare Financiare dhe të tjera

Nga Institucionet Ndërkombëtare Financiare me ndikim paraqiten Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, anëtar e të cilave Kosova është që nga viti 2011. Sidomos bashkëpunim i Kosovës me FMN paraqitet me interes dhe i rëndësishëm edhe për faktin se Kosova është anëtare e këtyre dy institucioneve ndërkombëtare financiare. Kosova pret që në të ardhmen të ndihmohet nga këto dy institucione përmes mbështetjeve buxhetore, kredive me kushte të volitshme.

Duhet të ceket se procesi buxhetor nuk mund të zhvillohet pa koordinimin dhe bashkëpunimin e këtyre institucioneve, e sidomos të FMN, ky proces gjithnjë e më shumë po paraqitet i koordinuar dhe në pajtueshmëri.

Gjithashtu, edhe Komisioni Evropian paraqet një partner me interes përRepublikën e Kosovës, përmes përkrahjes financiare dhe buxhetore.

5.5 Dorëzimi i Propozim-buxhetit dhe Aprovimi

5.6 Dorëzimi i Propozim-buxhetit

Pas përfundimit të procesit buxhetor, pas përfundimit të afateve dhe kompletimit të kërkesave buxhetore nga Organizatat Buxhetore, Ministria e Financavee kompleton këtë proces buxhetor dhe i dorëzon Qeverisë Propozim-Buxhetin e Republikës së Kosovës. Qeverisë duhet ta ketë kohën e mjaftueshme në dispozicion për shqyrtim dhe aprovim të propozim Buxhetit.

Propozim-buxheti duhet të përmbaj:

- Draft Ligjin Vjetor për Buxhetin e Republikës së Kosovës
- Dekleratën mbi synimet dhe prioritet e qevererisë;
- Përshkrimin e rrethanave ekonomike, në të cilat është përgatitur buxheti;
- Supozimet kyqe ekonomike që janë përdorur;
- Tabelat e Buxhetit;
- Numrin e të punësuarve;
- Vlerësimet dhe parashikimet për vitin e ardhshëm fiskal dhe së paku për dy vite pasuese;
- Deficitin fiskal, nëse pritet gjatë vitit;

- Dekleratën e misionit dhe planin e ekzekutimit, për Organizata Buxhetore;
- Donacionet e pritura;
- Informatat mbi suficitet buxhetore etj.

5.7 Aprovimi i Buxhetit

Aprovimi i Projketligjit të Buxhetit nga Qeveria - duhet të bëhet para datës 31 tetor, sepse kjo eshte kohor kur projectligji i dorëzohet Kuvendit të Kosovës. Projketligji vjetor i buxhetit përmban dispozitat ligjore, tabelat buxhetor, tabela 3.1, 3.2, 4.1, 4.2 dhe 4.3, por edhe material tjetër mbështetës.

Aprovimi i Ligjit të Buxhetit Vjetor nga Kuvendi i Kosovës–Pas aprovimit nga Qeveria projekt ligjit i dorzohet Kuvendit per shqyrtim dhe aprovim.
Duhet theksuar se është një ligj që kërkon bashkëpunim me disa akter, para se gjithash i Organizatave Buxhetore, grupeve të interest, Ministrisë së Financave, e ku rol kyq dhe përgjegjësi ka Komisioni për Buxhet e Financa në kuader të Kuendit të Kosovës, por edhe komisioneve tjera të Kuvendit.
Pas shqyrtimit nga Komisionet bëhet leximi i parë i buxhetit në parim nga Kuvendi dhe më pas bëhen rregullimet e kërkuara nga ana e komisioneve përkatëse sipas amendamenteve të miratuara, pastaj bëhet leximi i dytë dhe aprovimi i ligjit të buxhetit nga ana e Kuvendit.

Dekretimi i ligjit të Buxhetit Vjetor nga Presidenti - Pas aprovimit nga Kuvendi i Kosovës, Ligji i dorëzohet Presidentit për dekretim, i cili më pastaj shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

VI. Ekzekutimi i Buxhetit

Pas aprovimit dhe shpalljes në Gazetën Zyrtare të Ligjit Vjetor të Buxhetit, me filimin e vitit buxhetor, i cili në Kosovë është i njëjti me vitin kalendarik, fillon zbatimi i Buxhetit në pajtim me udhëzimet e dhëna për pergaditjen e rrjedhën e paras së gatshme nga te gjitha organizatat buxhetore dhe te cilat plane duhet te dorzohen në thesar.

Plani i rrjedhës se paras se gatshme ka për qëllimqe të menaxhoj ndarjet buxhetore përmes alokimin, zotimin dhe shpenzimin e mjeteve sipas nevojave të organizatave buxhetore.

VII. Baza Ligjore

Kuadri ligjor dhe legjislacioni për proceset buxhetore paraqet gjithëpërfshirje dhe rregullim të qartë, me çka arrihet njëri nga plotësim kryesor i kushteve për të pasur një process ligjor dhe transparent buxhetor. Legjislacioni primar në Kosovë për Buxhet është i plotësuar edhe me legjislacionin sekundar ku më te rëndësishmit janë:

- Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;
- Ligji Vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës
- Ligji mbi Financat e Pushtetit Lokal;
- Rregulloret financier nga Thasari-MF

Me ndikim në procesin buxhetor janë edhe dokumente strategjike dhe politike që aprovon Qeveria, kuvëmëndje e theksuar duhet t'i kushtohet KASH-it.

VIII. Konkluzionet

-Ne baze te shqyrtimit te deritanishem teorik dhe praktik, ne vijim do te synojme qe te japim disa konkluzione dhe rekomandime, per nje spekter te gjere akteresh (politikberes ne nivel qendror e lokal, udheheqes ne institucione publike ne nivele te ndryshme, etj Se kendejmi, gjate trajtimit te buxhetit te vendit per vitet respektive, konkludojme si ne vijim:

- Nuk ka planifikim te mjaftueshem te buxhetit, në bazë të performancës,
- Disciplina financiare eshte në nivel jo te mjaftueshem,
- Vazhdimi i procesit të inkasimit të të hyrave në kufi i cili mund te jete shume me efikas,
- Lëvizjet (transferet) e shumta buxhetore brenda vitit fiskal, e veshtiresojne menaxhimin e buxhetit,
- Transparenca buxhetore jo e mjaftueshme dhe kënaqshme,
- Aplikimi i nën-zërave buxhetor (kodi 5 shifror) jo i kënaqshëm, te jete me efeikas dhe efektiv.
- Legjislacioni i ri dhe politika të reja pa financim të mjaftueshëm buxhetor;
- Mos kordinimi dhe përfshirja me kohë e akterëve me ndikim në vendimmarrje gjatë procesit të rregullt buxhetor.

IX. Rekomandimet

Nga se u tha me siper në këtë punim, ne vijim do të paraqesim disa rekomandime konkrete:

- Buxheti të jetë sa më gjithëpërfshirës, transparent dhe publik, për të qenë në interes të të gjithë qytetarëve, ku përmes tatimeve dhe taksave që u mirren t'u kthehet në plotësim të nevojave publike dhe rritjes së mirëqenies ekonomike.
- Nëse gjatë vitit të hyrat e përgjithshme fiskale tejkalojnë të hyrat e buxhetuara më shumë se 5% pjesa tepricë t'u ndahet komunave në përputhje me kriteret e kalkulimit të Grantit të Përgjithshëm (të përcillet me azhurimin e KASH-it gjatë procesit të e rishikimit buxhetor ose në pjesën e dytë të vitit fiskal);
- Të ekziston një lidhshmëri më e madhe kontinuele në mes Buxhetit vjetor, KASH-it dhe dokumenteve strategjike;

- Të zhvillohet procesi i integruar i Buxhetit, përmes koordinimit institucional të përfshira në proces;
- Planifikimi i buxhetit të bëhet në bazë të performancës;
- Të zhvillohet koncepti i buxhetimit afatgjatë për projektet kapitale,si dhe projektet që kanë kosto të lartë buxhetore dhe strategjike të përgatiten duke marrë për bazë analizën e kostë-përfitimit. Po ashtu, planifikimi i projekteve kapitale të bëhet në bazë të prioriteteve të përcaktuara me strategjitë zhvillimore;
- Mbledhja e të hyrave në kufi të zvoglohet dhe të rritet mbledhja e të hyrave brenda vendit,
- Aplikimi i nën-zërave buxhetor me proces të planifikimit të buxhetit (kodi 5 shifror) duhet të bëhet në përputhje me kodet përkatëse për shpenzimet reale nga organizatat buxhetore, për të evituar diskrepancën në mes planifikimit dhe shpenzimit buxhetor gjatë vitit fiskal.

X. Literatura

- Bundo, Sherif (2008). Financat Publike, Tirane,
- Komoni, Sabahudin (2012). Finance, Prishtine,
- Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2017-2019;
- Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive (LMFPP Nr. 03/L-048, i cili ndryshohet dhe plotësohet me ligjet Nr.03/L-221, Nr. 04/L-116 dhe Nr.04/L-194);
- Ligji Vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017; 2018, 2019, 2020, 2021
- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049;
- Plani vjetor i punës së Qeverise per vitin 2017;2018, 2019, 2020, 2021
- Program i Qeverisë 2020-2022;
- Qarkoret Buxhetore per vitin 2017-2019; 2020-2022
- Rregullat financiare nga Thesari-Ministria e Financave;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021;